



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI: E DREJTA CIVILE

TEMA:

AKTVDEKJA DHE PROCEDURA PËR TRASHËGIMI PAS PRANIMIT TË AKTVDEKJES

Kandidatja:
Shahadije Osmani

Mentorja:
Doc. Dr. Arta Selami Bakiu

Nëntor, 2022

DEKLARATË E AUTORËSISË

Kjo deklaratë është bërë më datën 13.11.2022

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se teza e diplomës me titull: “Aktvdekja dhe procedura për trashëgimi pas pranimit të aktvdekjes” është rezultat i punës sime disamujore. Deklaroj se kjo tezë nuk është kopjuar nga asnjë punim tjetër, përpos burimeve të cituara sipas standardeve ndërkombëtare dhe as nuk është pjesë e ndonjë publikimi tjetër. Vërtetoj se unë jam autorja e këtij punimi dhe Universitetit i bartën të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Data e dorëzimit të punimit __.__._____

ABSTRAKTI

Vdekja është një nga proceset më të natyrshme. Vdekja është ndërprerje e plotë e jetës së një organizmi të gjallë. Moment i vdekjes së njeriut është moment i paparashikueshëm i cili mund të ndodhë në çdo çast. Disa persona vdesin jashtë nga institucionet shëndetësore, ndërsa disa në institucione shëndetësore. Në të dyja rastet duhet konstatimi i vdekjes nga ana e mjekut dhe lëshimi i vërtetimit mjekësor për vdekjen. Meqë është një procedurë shumë e rëndësishme është mirë që secili të ketë të paktën njohuri bazë për rrjedhën e procedurës. Kjo ishte edhe arsyeja se pse vendosëm ta analizojmë në detaje rrjedhën e procedurës që nga momenti i vdekjes dhe procedurat spitalore. Gjatë hulumtimit do të përpiqemi të shpjegojmë procedurën që nga lëshimi i vërtetimit të personit të vdekur, dokumentacionet e nevojshme dhe mënyrën praktike të dorëzimit të kufomës familjarëve të tij. Gjithashtu edhe në raste të veçanta shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur. Do të të shpjegojmë procedurën që pason pas marrjes së vërtetimit dhe regjistrimin e të vdekurit në librat amë të të vdekurve nga ana e ofiqarit kompetent si dhe përpilimi i aktvdekjes. Aktvdekja, si dëshmi dhe si dokument i domosdoshëm për hapjen e procedurës së trashëgimisë etj.

Fjalët kyçe: *aktvdekje, vdekje, vërtetim mjekësor, dokumentacion, kufomë, familjar.*

АПСТРАКТ

Смртта е еден од најприродните процеси. Смртта е целосен прекин на животот на живиот организам. Моментот на човечка смрт е непредвидлив момент што може да се случи на која бил момент. Некои луѓе можат да умрат надвор од здравствените установи, а некои во здравствените установи. И во двата случаи, лекарот мора да ја потврди смртта и да издаде лекарско уверение за смртта. Бидејќи станува збор за постапка што секој треба да има барем основно познавање на текот на постапката, сметам дека е разумно детално да го анализирам текот на постапката од моментот на смртта и болничките процедури.

Во овој труд ќе се обидам да ја објаснам постапката од издавањето на потврдата за починатиот, потребната документација и практичниот начин на доставување на телото до неговото семејство. Исто така, во посебни случаи прогласувањето на исчезнатото лице за мртво. По добивањето на потврдата, ќе се обидам да ја објаснам постапката за регистрација на починатиот во матичните книги на починатиот од страна на надлежниот регистратор и составувањето на потврдата за смртта. Потврда за смрт, како доказ и како неопходен документ за отворање на постапката за наследство.

Клучни зборови: *потврда за смрт, смрт, лекарска потврда, документација, труп, семејство.*

ABSTRACT

Death is one of the most natural processes. Death is the complete cessation of life of a living organism. The moment of human death is an unpredictable moment which can happen at any cast. Some people may die outside of health facilities and some in health facilities. In both cases, the doctor must confirm the death and issue a medical certificate of death. Since it is a procedure that everyone should have at least a basic knowledge of the course of the procedure, I found it reasonable to analyze in detail the course of the procedure from the moment of death and hospital procedures.

In this papwr I will try to explain the procedure from the issuance of the certificate of the deceased, the necessary documentation and the practical way of delivering the body to his family. Also in special cases the declaration of the missing pwrson to be dead. After receiving the certificate, I will try to explain the procedure of registration of the deceased in the registry books of the deceased by the competent registrar and the compilation of the death certificate. Death certificate, as evidence and as a necessary document for the opening of the inheritance procedure.

Key words: *death certificate, death, medical certificate, documentation, corpse, family.*

1. Lënda e hulumtimit

Lënda e këtij hulumtimi do të jetë kalimi i procedurës nëpër etapa, nga fillimi siç është vërtetimi i personit të vdekur apo shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur e deri te procedura e hapjes së trashëgimisë. Kam zgjedhur për analizë këtë temë meqë është e domosdoshme të jenë të informuar për këtë procedurë edhe personat që nuk kanë përgatitje profesionale juridike. Hulumtimi im do të përfshijë analizën e detajuar të kornizës ligjore me anë të së cilës iniciohet dhe zhvillohet procedura nga ana e organeve kompetente në pajtim me rregulloren e spitalit të qytetit (Shkup), Ligjin për procedurë jokontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjin për noteri të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vdekja është një nga proceset më të natyrshme. Vdekja është ndërprerje e plotë e jetës së një organizmi të gjallë. Momenti i vdekjes së njeriut është moment i paparashikueshëm i cili mund të ndodhë në çdo çast. Disa persona mund të vdesin jashtë institucioneve shëndetësore dhe disa në institucione shëndetësore. Në të dyja rastet duhet konstatimi i vdekjes nga ana e mjekut dhe lëshimi i vërtetimit mjekësor për vdekjen. Meqë është një procedurë që secili është mirë të ketë të paktën njohuri bazë për rrjedhën e procedurës, e pamë të arsyeshme të analizojmë në detaje rrjedhën e procedurës që nga momenti i vdekjes dhe procedurat spitalore.

E drejta procedurale jokontestimore është sistem rregullash procedurale me të cilat rregullohet struktura e procedurës jokontestimore, pozita dhe roli i subjekteve procedurale, aktivitetet procedurale të tyre dhe raportet reciproke midis tyre. Strukturën e procedurës jokontestimore e përbëjnë dy lloje të procedurave edhe atë procedurat jokontestimore personale dhe procedurat jokontestimore pasurore. Është me rëndësi të analizohet edhe duke marrë parasysh faktin që detyrat e shumta të gjykatave pamundësonin zgjidhje të shpejtë dhe efikase të lëndëve jokontestimore nga lënda e të drejtës trashëgimore si shqyrtimi i trashëgimisë, nga 1 marsi i vitit 2008 të gjitha ingerencant si përfaqësues të gjykatës i kaluan noterëve, të cilët janë të autorizuar t'i ndërmarrin të gjitha vendimet përveç atyre të cilat me Ligjin për procedurë jokontestimore janë përcaktuar ndryshe.

Në këtë punim do të përpiqemi të shpjegojmë procedurën që nga lëshimi i vërtetimit të personit të vdekur, dokumentacionet e nevojshme dhe mënyra praktike e dorëzimit të kufomës familjarëve të tij. Gjithashtu edhe në raste të veçanta shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur. Pas marrjes së vërtetimit do të mundohemi të shpjegojmë procedurën e regjistrimit të të vdekurit në librat amë të të vdekurve nga ana e ofiqarit kompetent si dhe përpilimi i aktvdekjes. Aktvdekja, si dëshmi dhe si dokument i domosdoshëm për hapjen e procedurës së trashëgimisë.

Po ashtu, lëndë e këtij studimi do të jetë edhe noteri, respektivisht kompetencat e Noterit si përfaqësues të gjykatës të përmbajtura në Ligjin për procedurë jokontestimore dhe Ligjin për noter. Për të pasur një pasqyrë më të qartë për pozicionin e procedurës trashëgimore apo institutit të trashëgimisë, do të analizojmë dhe do të studiojmë edhe zhvillimin historik të këtij instituti që nga fillimet e tij e deri më sot.

Në fund, këtij punimi do t'i bashkëngjisim edhe disa shembuj të dokumentacioneve me të cilat do të ballafaqohemi gjatë të gjithë procesit.

2. Qëllimet e hulumtimit

Përzgjedhja e kësaj teme për hulumtim ka për qëllim studimin dhe analizimin e normave procedurale juridike, siç janë normat ligjore të procedurës jokontestimore. Qëllimi i hulumtimit të kësaj teme është thjeshtëzimi apo interpretimi i normave ligjore të cilat rregullojnë procedurën e fundit jetësore të personit, me konstatimin e vdekjes së tij e deri te hapja e trashëgimisë apo marrëdhënia e tij juridike trashëgimore. Është e rëndësishme të studiohet roli dhe rëndësia e procedurës, rregullativa ligjore e procedurës jokontestimore, roli dhe aktiviteti i noterëve si dhe hapja e trashëgimisë si punë juridike e personit të vdekur e cila është punë *mortis causa* dhe paraqitet pas vdekjes së personit.

Në këtë punim do të sqarohet puna e disa institucioneve, duke filluar nga institucionet shëndetësore, shtetërore por edhe ato private, si dhe punët noteriale si përfaqësues ligjorë gjyqësorë.

3. Hipotezat

- Cila është përgjegjësia e personelit spitalor për lëshimin e personit të vdekur?
- Cila është rëndësia e aktvdekjes?
- Kur përpilohet aktvdekja?
- Ligji i procedurës trashëgimore - kompetencat.
- Sa janë ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut të mjaftueshme për rregullimin e procedurës së aktvdekjes?

4. Metodologjia e hulumtimit

Si bazë për mënyrën e hulumtimit do të jenë ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për dualizmin dhe mënyrën e shfrytëzimit të nenit adekuat të ligjit përkatës. Për të realizuar qëllimin e këtij punimi do të përdorim metodën teorike dhe atë praktike, nëpërmjet të cilave e gjithë procedura të jetë sa më e thjeshtëzuar dhe më e kapshme për çdonjërin i cili do të ballafaqohet me këtë punim. Do ta përgatisim këtë punim në atë mënyrë që personalisht të vizitojmë çdo institucion për të analizuar nga afër rrjedhën e procedurës. Gjithashtu në këtë punim do të sigurojmë edhe shembuj të dokumentacioneve të nevojshme, të cilat i hasim gjatë procedurës për t'ia bashkangjitur këtij punimi që të jetë sa më i kompletuar.

A: Si metodë teorike do të përdorim:

1. METODËN NORMATIVE: si metodë shumë të rëndësishme duke marrë si bazë rregullativën ligjore të një shteti, konkretisht të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. METODËN KOMPARATIVO-HISTORIKE: duke analizuar historikisht ndryshimet ligjore dhe duke bërë krahasimin se si ka qenë dhe si është ndryshuar tani.
4. METODËN E DEDUKSIONIT: do të përdoret me qëllim që nëpërmjet kësaj metode të arrijmë deri në konstatime të sakta. Pra, me anë të kësaj metode, nga konstatime të përgjithshme do të mundemi të arrijmë në konstatime konkrete. Përveç metodës së deduksionit do të përdorim edhe metodën analoge të saj, metodën e induksionit nëpërmjet së cilës nga konstatime konkrete do të mundemi të nxjerrim konstatime të përgjithshme.

B: Si metodë praktike:

1. METODA PRAKTIKE: Metodën praktike do ta përdorim që ky punim të jetë një sfidë për ne dhe nëpërmjet saj ta interpretojmë dhe ta analizojmë sa më mirë në këtë punim.

5. Rëndësia e punimit

Studimi dhe hulumtimi i rrjedhës së procedurës që nga konstatimi i vdekjes së personit fizik e deri te hapja e trashëgimisë do të jetë një punë kërkimore për të analizuar çështjet e zhvillimit të procedurës deri te inicimi i procedurës trashëgimore.

Aktivdekja është punë juridike *mortis causa*, e cila inicohet pas vdekjes së personit apo shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur, duke bërë regjistrimin e vdekjes në librat e amzës nga ofiqari kompetent. Është e rëndësishme se me vdekjen e personit hapet një procedurë e re e cila zhvillohet vetëm pas marrjes së aktivdekjes dhe konstatimin e personit për të vdekur.

Fokusim të veçantë për hartimin e këtij punimi përveç anës praktike vend të veçantë do të ketë edhe analizimi dhe implementimi i rregullave dhe akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim të funksionimit sa më efikas të organeve kompetente për zhvillimin e të gjithë procedurës.

Shpresojmë që punimi i kësaj teze do t'u hyjë në punë edhe personave me përgatitje profesionale, studentëve të drejtimit juridik, por gjithashtu edhe personave pa përgatitje juridike.

PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORËSISË.....	2
ABSTRAKTI	3
ΑΠΣΤΡΑΚΤ	4
ABSTRACT	5
1. Lënda e hulumtimit	6
2. Qëllimet e hulumtimit	7
3. Hipotezat.....	8
4. Metodologjia e hulumtimit	8
5. Rëndësia e punimit	9
HYRJA	12
KAPITULLI I	13
1. AKTVDEKJA.....	13
1.1. Kuptimi i aktvdekjes	13
1.2. Aktvdekja si punë juridike “mortis causa”	14
1.2.1. Aktvdekja si vërtetim për shuarjen e personit fizik.....	15
1.2.2. Kuptimi i personit fizik	16
1.2.3. Aftësia juridike e personit fizik	16
1.2.4. Vdekja si fakt juridik për pushimin e aftësisë juridike të personit fizik.....	17
1.2.5. Shpallja e personit të zhdukur për të vdekur si fakt juridik për pushimin e aftësisë (zotësisë) juridike të personit fizik	17
KAPITULLI II	19
2. VËRTETIMI I VDEKJES	19
2.1. Raporti mjekësor për arsyen e vdekjes	19
2.2. Raporti mjekësor për personin fizik i cili para vdekjes ka qenë nën përkujdesje mjekësore	20
2.3. Arsyeja e vdekjes	22
2.3.1. Përgjegjësia mjekësore	22
2.4. Obduksioni (Autopsia)	24
2.4.1. Nevoja për obduksion	25
2.5. Fletëlëshimi i personit të vdekur	26

2.5.1. Transporti i kufomës nga spitali te familjarët	26
2.6. Vdekja e shtetasit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut	27
2.6.1. Leja për bartjen e personit të vdekur në vendin e tij (shtetasit e huaj)	28
KAPITULLI III.....	29
3. PROCEDURA E TRASHËGIMISË.....	29
3.1. Nocioni dhe parimet e së drejtës trashëgimore	29
3.1.1. Parimet e së drejtës trashëgimore	30
3.2. Kategoritë themelore të së drejtës trashëgimore	32
3.3. Radhët e trashëgimisë sipas Ligjit për trashëgimi të RMV	35
3.3.1. Dispozitat e veçanta për disa trashëgimtarë	36
3.4. Testamenti dhe revokimi	36
3.4.1. Revokimi i testamentit	37
KAPITULLI IV.....	38
4.1. Procedura e Gjykatës për trashëgimi pas pranimit të aktvdekjes	38
4.2. Seanca për shqyrtimin e trashëgimisë	42
4.3. Mbajtja e seancës.....	47
4.4. Ndërprerja e seancës së trashëgimisë.....	49
4.5. Miratimi i aktvendimit	51
PËRFUNDIMET.....	53
REKOMANDIMET	54
BIBLIOGRAFIA	55
FALËNDERIM	64

HYRJA

E drejta procedurale jokontestimore është sistem rregullash procedurale me të cilat rregullohet struktura e procedurës jokontestimore, pozita dhe roli i subjekteve procedurale, aktivitetet procedurale të tyre dhe raportet reciproke midis tyre. Strukturën e procedurës jokontestimore e përbëjnë dy lloje të procedurave edhe atë procedurat jokontestimore personale dhe procedurat jokontestimore pasurore. Është me rëndësi të analizohet edhe duke marrë parasysh faktin që detyrat e shumta të gjykatave pamundësonin zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të lëndëve jokontestimore nga lënda e të drejtës trashëgimore, si shqyrtimi i trashëgimisë, nga 1 marsi i vitit 2008 të gjitha kompetencat si përfaqësues të gjykatës i kaluan noterëve, të cilët janë të autorizuar t'i ndërmarrin të gjitha vendimet, përveç atyre të cilat me Ligjin për procedurë jokontestimore është e përcaktuar ndryshe.

Zhvillimi i procedurës së aktvdekjes nëpër etapa nga fillimi siç është vërtetimi i personit të vdekur nga mjekësia ligjore apo shpallja e personit të zhdukur për të vdekur, më pas lëshimi i vërtetimit për vdekjen e personit e deri në procedurën e hapjes së trashëgimisë, është e rregulluar në mënyrë ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke e parë nevojën për informimin e qytetarëve të rrjedhjës së procedurës së aktvdekjes e pamë të arsyeshme të përzgjedhim këtë temë, e cila është shumë e rëndësishme që edhe ata të jenë të informuar, pra që nuk kanë përgatitje profesionale juridike.

Ashtu sikurse me lindje krijohen të drejtat dhe detyrimet e personit fizik, ato edhe shuhen me vdekjen e tij. Hulumtimi im do të përfshijë analizën e detajuar të kornizës ligjore me anë të së cilës inicohet dhe zhvillohet procedura nga ana e organeve kompetente në pajtim me rregulloren e spitalit të qytetit (Shkup), Ligjin për procedurë jokontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjin për noteri të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI I

1. AKTVDEKJA

1.1. Kuptimi i aktvdekjes

Aktvdekja është dokument zyrtar i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, i cili përpilohet me vdekjen apo me shpalljen e një personi të zhdukur për të vdekur. Fjala aktvdekje apo ndryshe aktvërtetim nënkupton një veprim zyrtar apo dokument i gjendjes civile i cili vërteton vdekjen e dikujt.

Aktvdekja në kuptimin objektiv nënkupton tërësinë e normave juridike të cilat rregullojnë përpilimin e aktvdekjes, përkatësisht përmbajtjen e aktvdekjes që do të thotë tërësinë e normave juridike me të cilat caktohet momenti i aplikimit për përpilimin e aktvdekjes, të dhënat e të vdekurit si dhe personat të cilët kanë të drejtë në kërkesën për aktvdekje. Sipas Ligjit për procedurë jokontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nenit 144, paragrafit një dhe dy aktvdekja definohet si dokument i cili përpilohet çdoherë kur ndonjë person vdes ose shpallet si i vdekur, pa marrë parasysh nëse ka ose nuk ka pasuri;

Aktvdekja përpilohet në bazë të të dhënave të marra nga familjarët e të vdekurit, nga personat me të cilët i vdekuri ka jetuar, si dhe nga personat e tjerë të cilët mund të japin të dhëna që do të shënohen në aktvdekje.¹

Për t'u përpiluar aktvdekja duhet të bëhet regjistrimi i vdekjes në librat amë të të vdekurve nga ana e ofiqarit kompetent. Sipas nenit 142 të Ligjit për procedurë jokontestimore të RMV ofiqari kompetent për përpilimin e aktvdekjes, pavarësisht nëse mund t'i grumbullojë të gjitha të dhënat për përpilimin e aktvdekjes apo jo. Në të dyja rastet ofiqari në afat prej 30 ditësh duhet t'i dorëzojë aktvdekjen gjykatës për trashëgimi. Në qoftë se ofiqari ka dorëzuar aktvdekjen pa grumbullimin e të gjitha të dhënave, atëherë ai është i detyruar që me dorëzimin e aktvdekjes gjykatës për trashëgimi t'i theksojë edhe shkaqet për të cilat nuk kanë mundur të sigurohen të dhënat. "Nëse ndonjë person ka vdekur jashtë rajonit të komunës në të cilën ka vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin, ofiqari do të mund t'ia

¹ Zakon za vonparnicna postapka, sl. ves. na RM, br. 09 od 18.01.2008 god.clen. 144

dorëzojë gjykatës për trashëgimi vetëm aktvdekjen nga libri amë i të vdekurve, si dhe të dhënat me të cilat disponon, e që mund të shërbejnë për përpilimin e aktvdekjes”.² Aktvdekja duhet të përmbajë sa më shumë të dhëna të personit të vdekur, mirëpo të detyrueshme janë të dhënat personale, siç janë: emri, emri i prindit dhe mbiemri (mbiemri i vajzërisë për personat e gjinisë femërore), profesionin të cilin e ka pasur, datëlindja, shtetësia si dhe numri amë i të vdekurit. Gjithashtu në aktvdekje shënohen edhe të dhënat e momentit të vdekjes: dita, muaji si dhe vendi i vdekjes, të dhënat mbi vendbanimin apo vendqëndrimin e të vdekurit, të dhënat personale të familjes më të ngushtë si dhe të atyre familjareve të cilët mund të ftohen në trashëgimi. Është e rëndësishme se aktvdekja është e rëndësishme në procedurën e trashëgimisë, në të vendosen edhe të dhënat mbi pronën si dhe vlefshmërinë e përafërt të asaj prone. Të dhëna të rëndësishme të cilat duhet të shënohen në aktvdekje për procedurën e trashëgimisë, në mënyrë të veçantë duhet të konfigurojnë edhe nëse pritet lindja e ndonjë fëmije. Kjo nënkupton se çdo e dhënë personale familjare apo farefisnore e cila do të jetë informacion i nevojshëm në procedurën e trashëgimisë duhet të konfigurojë edhe në aktvdekje.³ Me aktvdekje mund të nënkuptojmë në njëfarë mënyrë edhe përmbledhjen e të gjitha të dhënave të një personi nga lindja, veprimtaria, bashkësia familjare, pasuria e deri te momenti i vdekjes së personit fizik.

1.2. Aktvdekja si punë juridike “mortis causa”

Edhe pse në literaturë si punë juridike *mortis causa* konsiderohet vetëm testamenti), në bazë të shkakut të përpilimit momentit, rrethanave, edhe aktvdekja është punë juridike në rast të vdekjes (*mortis causa*). Aktvdekja është dokument publik të cilin e lëshon organi kompetent.

Testamenti paraqet deklarin e vullnetit të testamentlënësit lidhur me disponimin e trashëgimisë se tij në rast të vdekjes që do të thotë për përpilimin e testamentit duhet të ekzistojë vullneti i testamentlënësit që nënkupton se testamentlënësi duhet të jetë i gjallë, ta përpilojë testamentin me vullnetin e tij dhe duke respektuar kushtet e parapara me ligj që

² Zakon za vonparnicna postapka, sl.ves. na RM, br. 09 od 18.01.2008god.clen.142

³ <https://www.pravdiko.mk/prijavuvane-na-pochinato-litse-i-izdavane-na-izvod-od-matichna-kniga-na-umreni/>

ai testament të jetë i vlefshëm. Është e rëndësishme të theksohet se testamenti edhe pse ekziston, efekti i saj ndodh pas vdekjes së testamentlënësit që do të thotë testamenti si veprim juridik i sjell pasojat e dëshiruara nga trashëgimlënësi jo në kohën që testatori shfaq vullnetin e tij, por pas vdekjes së tij. Punët juridike civile që mundësojnë krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve civile, respektivisht të marrëdhënieve juridiko-civile, duke u mbështetur në kritere të ndryshme aktvdekja është punë juridike në rast të vdekjes (mortis causa) pasi pas vdekjes së personit fizik nuk mund të përpilohet aktvdekja për atë person; është punë juridike formale, pasi kemi të bëjmë me një dokument i cili për vlefshmërinë e tij kërkohet formë e veçantë e paraparë me ligj; është punë juridike e njëanshme, që nënkupton se me vdekjen e një personi paraqitet nevoja për përpilimin e aktvdekjes; aktvdekja është punë juridike kauzale – punë juridike ku kauza apo shkaku i arritjes së qëllimit apo shkaku i përpilimit të aktvdekjes është i dukshëm; aktvdekja është punë juridike komutative- në të cilën në momentin e përpilimit janë të njohura detyrat dhe detyrimi i palëve.

1.2.1. Aktvdekja si vërtetim për shuarjen e personit fizik

Akti i vdekjes është çështje faktike. Ashtu sikurse ekzistojnë regjistra të gjendjes civile për qëllime të caktuara, siç është regjistri i të lindurve, regjistri i të martuarve edhe regjistri i të vdekurve. Në regjistrin e të lindurve regjistrohen: akti i lindjes, adoptimi, pranimi i fëmijës së lindur jashtë martese, respektivisht mohimi dhe konstatimi i atësisë apo amësisë, vazhdimi i pushtetit atëror ose kujdestarisë, si dhe ndërrimi i emrit familjar dhe personal.⁴ Në regjistrin e të martuarve regjistrohen: martesë si dhe ndërrimet lidhur me martesën si shkurorëzimi dhe anulimi i martesës.⁵ Në regjistrin e të vdekurve regjistrohen: vdekja dhe shpallja e vdekjes së personit të zhdukur, si dhe të lindurit e vdekur të fëmijës.⁶ Nga kjo nënkuptojmë se ashtu sikurse me rastin e lindjes së personit ekziston detyrim për familjarët që të bëjnë regjistrimin e tij për t'u vërtetuar ekzistimi si dhe të drejtat e tij, gjithashtu me vdekjen e tij duhet bërë inicimi i procedurës për vërtetimin e vdekjes dhe përpilimin e aktvdekjes nga ana

⁴ КОНСОЛИДИРАН ТЕКСТ Закон за матичната евиденција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 8/1995, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/2013, 43/2014, 148/2015 и 27/2016).

⁵ КОНСОЛИДИРАН ТЕКСТ Закон за матичната евиденција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 8/1995, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/2013, 43/2014, 148/2015 и 27/2016).

⁶ КОНСОЛИДИРАН ТЕКСТ Закон за матичната евиденција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 8/1995, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/2013, 43/2014, 148/2015 и 27/2016).

e organeve kompetente për vdekjen si dhe shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve të personit fizik. Aktvdekja është dokument nëpërmjet të cilit vërtetohet gjendja faktike e personit fizik, që nënkuptojmë vdekjen e personit fizik.

1.2.2. Kuptimi i personit fizik

Me person fizik nënkuptojmë një individ të caktuar, një njeri konkret. Personi fizik është personalisht dhe pa kufizim përgjegjës për çdo detyrim të rrjedhur nga marrëdhëniet e tij. Persona fizikë janë të gjithë qytetarët e një vendi. Person fizik është njeriu i gjallë si subjekt i së drejtës, dhe bartës i zotësisë juridike – titullar i të drejtave dhe detyrimeve.⁷ Në literaturë thuhet se “personi fizik” nënkupton njeriun në rolin e titullarit të të drejtave dhe detyrimeve.⁸ Sipas të drejtës bashkëkohore të gjithë personat fizikë posa lindin bëhen subjekt të së drejtës, pra personi fizik krijohet me aktin e lindjes.⁹

1.2.3. Aftësia juridike e personit fizik

Aftësia juridike është aftësia apo zotësia për të pasur të drejta dhe detyrime. Zotësinë juridike e gëzon çdo person fizik. Personi fizik, si subjekt i së drejtës, gëzon zotësinë juridike dhe, e kundërta, ekzistenca e zotësisë juridike si cilësi e personit fizik bën që ai të jetë subjekt i së drejtës. Aftësia apo zotësia juridike fillon me lindjen e personit të gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij, mirëpo duhet përmendur faktin që fëmija i cili lind i gjallë gëzon aftësinë juridike që nga koha e zënies. Kushti i vetëm kryesor për të pasur zotësi juridike është që personi fizik të lind i gjallë.¹⁰ Nëse një person nuk ka zotësinë e veprimit kjo nuk nënkupton se ai nuk ka aftësi juridike, që do të thotë se edhe personat e paaftë për të gjykuar mund të jenë titullar të të drejtave dhe detyrimeve (titullar i pronësisë dhe atë pa kufi), por ai nuk mund vetë t’i ushtrojë të drejtat dhe detyrimet e veta në mënyrë të pavarur për shkak se i mungon zotësia për të vepruar. Sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë të vitit 1994, neni 1, “Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuara me ligj”, ndërsa sipas nenit 2 të këtij

⁷ Aliu, A. “E drejta civile”, Prishtinë, 2013, e cituar, fq. 235.

⁸ Rašović, Zoran, Vepra e cituar, fq. 50.

⁹ Gams, A, Vepra e cituar, fq. 114.

¹⁰ Rodna Zhivkovska, “Stvarno Pravo”, Skopje, 2005.

kodi parashihet se: “Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij”.¹¹

Zotësia juridike mund të përcaktohet si cilësi abstrakte dhe e përgjithshme. Zotësia juridike është një zotësi e plotë dhe e barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile dhe, si e tillë, ajo është e patjetërsueshme dhe e patransferueshme. Vetëm me ligj mund të zgjerohen ose të ngushtohen kufijtë e zotësisë juridike të personave, pasi zotësia apo aftësia juridike gëzohet brenda kufijve të përcaktuara me ligj. Aftësia juridike është një cilësi e pandashme nga vetë njeriu dhe nuk varet nga gjendja e tij shëndetësore, mosha ose nga fakti nëse ka mundësi t’i ushtrojë ose jo të drejtat e caktuara.

1.2.4. Vdekja si fakt juridik për pushimin e aftësisë juridike të personit fizik

Aftësia juridike vazhdon deri sa personi fizik të jetë në jetë dhe shuhet me vdekjen e tij apo shpalljen e tij për të vdekur. Ashtu sikurse lind zotësia juridike ajo edhe mbaron me vdekjen e personit. Për të ardhur pasojat juridike, vdekje e personit konsiderohet vdekja natyrore si dhe vdekja e prezumuar. Akti i vdekjes është çështje faktike, ekziston procedurë e veçantë për konstatimin e saj, duke u mbështetur në vendimet e mjekësisë ligjore, ose mjekësisë së përgjithshme.¹²

1.2.5. Shpallja e personit të zhdukur për të vdekur si fakt juridik për pushimin e aftësisë (zotësisë) juridike të personit fizik

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës. Ashtu sikurse me vdekjen e tij të natyrshme shuhet aftësia juridike, e njëjta ndodh edhe me personat e zhdukur të shpallur për të vdekur. Shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur e bën gjyqi kompetent me aktvendim, pas ngritjes së procedurës në bazë të Ligjit për procedurë jokontestimore të RMV dhe pas skadimit të afatit të shpalljes në të cilën thirret personi i zhdukur.

¹¹ Graganski zakonik na RSM.

¹² Aliu, A. “E drejta civile”, Prishtinë, 2013, fq. 236.

Për dallim nga personat e vdekur të cilët automatikisht shuhet zotësia juridike të personat e zhdukur për të vdekur, në bazë të Ligjit për procedurë jokontestimore neni 83, i cili thotë “Nëse personi i zhdukur i shpallur si i vdekur paraqitet personalisht në gjyq, gjyqi pasi të konfirmojë identitetin e tij, pa procedurë të mëtejshme, do ta shfuqizojë aktvendimin e vet për shpalljen e atij personi si të vdekur”.¹³ Me këtë ligj nënkuptohet që pas shfuqizimit të këtij aktvendimi personit të zhdukur për të vdekur i kthehet edhe zotësia juridike.

Ekziston dilema se personi i zhdukur për të vdekur, a ka pasur zotësi juridike gjatë periudhës nga plotfuqishmëria e aktvendimit të shpalljes së tij të zhdukur për të vdekur deri te riparaqitja e tij. Lirisht mund të thuhet se ka pasur në ndonjë vend tjetër, në qoftë se nuk ka qenë e mundur të jetë i informuar për shpalljen e zhdukjes së tij. Mirëpo po të njëjtës periudhë nga plotfuqishmëria e aktvendimit e deri te paraqitja e tij në organet kompetente në RMV ai nuk mund të konsiderohet se ka pasur aftësi apo zotësi juridike.

Sipas nenit 91 të Ligjit për procedurë jokontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili thotë: “Aktvendimi i plotfuqishëm me të cilën dëshmohet vdekja e ndonjë personi, dorëzohet te ofiqari kompetent, për regjistrimin në librat amë të të vdekurve”.¹⁴ Në bazë të regjistrimit bëhet edhe përpilimi i aktvdekjes.

¹³ Ligji për procedurë jokontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 83.

¹⁴ Ligji për procedurë jokontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 91.

KAPITULLI II

2. VËRTETIMI I VDEKJES

2.1. Raporti mjekësor për arsyen e vdekjes

Sipas Ligjit për mbrojtje shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rastin e vdekjes apo rastin e një të porsalinduri pa jetë, janë të detyruar menjëherë ta paraqesin anëtarët e familjes së personit të vdekur, nëse nuk ka të tillë apo nuk e dinë për ngjarjen, çdo person tjetër i cili e din për ngjarjen apo e ka gjetur personin e vdekur. Rasti i vdekjes apo rasti i një të porsalinduri të vdekur paraqitet te personat e kualifikuar për kontroll të personave të vdekur, gjegjësisht në inspektoratin shtetëror sanitar dhe shëndetësor dhe organin kompetent shtetëror për punë të brendshme në rajonin të cilin ka vdekur personi, gjegjësisht është gjetur personi i vdekur”.¹⁵ Kontrolli për personin e vdekur sipas rregullit bëhet 2 orë pas vdekjes së personit në vendin e vdekjes e më së voni 12 orë pas paraqitjes së rastit. Pas mbarimit të kontrollit të personit të vdekur, personi i kualifikuar jep dhe vërtetimin për vdekjen.¹⁶

Do të vlerësohet se personi ka vdekur në fakt kur të vërtetohet me raport mjekësor, në të cilin saktësohet, identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjek, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Pas kontaktit fizik me kufomën dhe vërtetimit të vdekjes personi i kualifikuar i cili ka vërtetuar vdekjen është i detyruar të përpilojë raport për vdekjen e personit. Varësisht nga momenti dhe mënyra e vdekjes plotësohet raporti mjekësor ku vërtetohet vdekja.

Në RMV Ligji për regjistrim civil parashikon dokument i cili është “Vërtetim për vdekje dhe raport mjekësor për arsyen e vdekjes”, i cili lëshohet nga organet kompetente. Ky raport në vete përmban të dhëna personale (të mbrojtura në pajtim me Ligjin për statistika shtetërore),¹⁷ siç janë: emri dhe mbiemri i të vdekurit; gjinia; data e vdekjes; vendi, rruga, komuna ku ka vdekur; data e lindjes, numri amë (për fëmijën në moshën nën njëvjeçare

¹⁵ Ligji për mbrojtje shëndetësore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 271.

¹⁶ Ligji për mbrojtje shëndetësore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 272.

¹⁷ Zakon za drzavna statistika na RSM Службен весник на Република Македонија” бр. 54/1997, 21/2007, 51/2011, 104/2013 , 42/2014, 192/2015, 27/16, 83/18, 220/18, 31/20.

edhe numri amë i nënës); të dhëna mbi vendin, rrugën, komunën, shtetin ku ka qenë i lindur; vendi, rruga, komuna, shteti ku ka jetuar (në bazë të letërnjoftimit), statusi martesor; shtetësia; përkatësia etnike; emrat e prindërve; profesioni; llojin e vdekjes (nëse ka qenë vdekje natyrale, e dhunshme, vdekje në aksident, vetëvrasje, apo vrasje); të dhëna mbi atë nëse i vdekuri ka qenë më herët në shërim nga sëmundja e cila mund të ketë qenë shkaktar i vdekjes (të dhëna mbi shërimin e mëhershëm); vendi i vdekjes (a ka qenë institucion shëndetësor, në banesë apo diku tjetër); emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit i cili ka vërtetuar vdekjen; arsyeja e vdekjes (sëmundja apo shkaktari që ka sjellë vdekjen, shkaqe të mëhershme etj.); emri, mbiemri dhe nënshkrimi i mjekut i cili e ka dhënë arsyen e vdekjes; në rast obduksioni këtij raporti i bashkëngjitet edhe raporti nga obduksioni. Në raport ka dhe një vend të posaçëm për ofiqarin kompetent, ku nëpërmjet këtij raporti bën regjistrimin e rastit në librin amë të të vdekurve në vendin dhe komunën ku i vdekuri ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nënshkrimi i ofiqarit. Ky vërtetim plotësohet për të gjithë të vdekurit, edhe për ata të cilët kanë vdekur në institucione shëndetësore, por edhe diku tjetër.

Jo çdokush mund të jetë i kualifikuar për kontrollin e personave të vdekur. Sipas nenit 268 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut konsiderohet se kontrollin e personave të vdekur e bëjnë: njerëz të kualifikuar dhe zëvendësit e tyre, të cilët i emëron Ministri i Shëndetësisë, me propozim nga qendra shëndetësore. Në paragrafin 2 të të njëjtit nen thuhet: “për kontroll të personave të vdekur emërohen punëtorët shëndetësorë specialist në drejtim të mjekësisë ligjore apo patologjisë, punëtorë shëndetësorë, të cilët kanë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, kanë licencë për punë dhe kanë të mbaruar me sukses trajnimin e duhur për të kryer kontrollin e të vdekurve”.¹⁸

2.2. Raporti mjekësor për personin fizik i cili para vdekjes ka qenë nën përkujdesje mjekësore

Te personat në trajtim mjekësor si të ata të cilit kanë vdekur duke qenë në trajtim mjekësor para vdekjes detyrimisht plotësohet edhe “Raport për mjekim stacionar të pacientit”. Ky raport plotësohet nga dhoma intensive-shok, gjegjësisht nga mjeku i cili ka qenë nën

¹⁸ Ligji për mbrojtje shëndetsore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 268.

përkujdesje të pacientit (para vdekjes). Raporti mjekësor përmban të dhëna mbi emrin dhe vendndodhjen e spitalit që ka qenë nën përkujdesje të pacientit. Gjithashtu ky raport përmban dhe të dhëna personale për pacientin i cili ka vdekur, siç janë: emri, mbiemri i pacientit; rruga (vendi dhe komuna); numrin e historisë së sëmundjes (i cili nxirret në momentin e pranimit të pacientit në spital); numri amë i të siguruarit; kategoria e sigurimit shëndetësor (i siguruar në marrëdhënie pune, sigurim bujqësor, i pasiguar, apo të tjera); nëse ka qenë i aftë për punë apo jo; koha e pranimit në spital (data, muaji dhe viti); koha e çlajmërimit apo lëshimit nga spitali (data, muaji dhe viti); të dhëna mbi sëmundjen, natyrën e lëndimit, gjegjësisht gjendjen për të cilën është shëruar apo operuar; llojin e lëndimit (nëse ka qenë në punë, rrugës prej pune, në shtëpi apo diku tjetër); shkaqet e jashtme të lëndimit; koha e lëndimit (ora, dita, muaji); rehabilitimi (i aftë për punën e tij, i aftë për punë me kusht për rikualifikim, i aftë për aktivitete të përditshme, i aftë për punë me orar të shkurtuar apo i mjekuar me sukses); për të vdekurit shkakun kryesor të vdekjes; si dhe nëse është bërë obduksion apo jo. Raporti për mjekim stacionar të pacientit i dërgohet fondit shëndetësor i cili më pas bën shpërndarjen e tij nëpër komunat në të cilat pacienti jeton apo ka jetuar para vdekjes.

Edhe Ligji për mbrojtje shëndetësore i RMV¹⁹ rregullon çështjen e dokumentacionit të personave të vdekur në institucione shëndetësore, ku është theksuar: “Personat që vdesin në institucione shëndetësore arsyeja e vdekjes vërtetohet në institutin e lartë nga fusha e mjekësisë ligjore ose patologjisë”.²⁰ Vdekja e secilit pacient në institucion shëndetësor është patjetër të analizohet veçmas në kolegiumin e ekspertëve të institucionit, ku pacienti ka vdekur. Dokumentacioni mjekësor për personin e vdekur me mendimin e ekspertëve të kolegiumit si dhe konstatimin e mjekësisë ligjore apo patologjisë (në rast obduksioni), patjetër duhet të dorëzohen te komisioni për kualitetin e institucionit shëndetësor më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e vdekjes. Ai komision detyrimisht analizon me kujdes të gjithë dokumentacionin mjekësor, mendimet dhe konstatimet. Komisioni për kualitetin shëndetësor pas shqyrtimit të lëndës veçmas të çdo pacienti të vdekur është i detyruar ta dërgojë mendimin e tij deri te Ministria e Shëndetësisë, më së voni deri në

¹⁹ Ligji për mbrojtje shëndetësore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 270.

²⁰ Po aty, parag. 1.

fundin e muajit i cili vijon pas muajit në të cilin ka ndodhur vdekja.²¹ Ministria e Shëndetësisë gjithmonë i përshkruan të dhënat e mendimeve të komisionit për kualitetin e institucioneve shëndetësore.

2.3. Arsyeja e vdekjes

Natyrë e vdekjes së personit mund të jetë e ndryshme. Ajo varet nga mënyra, shkakët si dhe rrethanat të cilat e kanë sjellë vdekjen. Vdekja mund të jetë e natyrshme, apo si dhe pasojë e ndonjë sëmundje vdekjeprurëse. Vdekja mund të ndodhë edhe si pasojë e lëndimeve fizike, në raste të fatkeqësive natyrore e shumë shkaqe të tjera të ndryshme. Kemi raste kur vdekja është e dyshimtë apo që vdekja nuk ka ndodhur në mënyrë të natyrshme. Kur kemi vdekje të dyshimtë apo jemi të sigurt se vdekja nuk ka prejardhje të natyrshme, trupit të pajetë i bëhet nënshtrim mjekësor gjyqësor apo autopsi, si dhe ekspertizë mjekësore gjyqësore nga dy mjekë të cilët njëri duhet të jetë mjek specialist dhe tjetri mjek i mjekësisë ligjore. Mjekët specialistë si dhe ekspertët janë të përgatitur profesionalisht që ta verifikojnë dhe të japin rezultate të sakta për shkaktarin prej të cilit ka ardhur si pasojë vdekja.

Kemi shumë raste kur vdekja ndodh në institucionet shëndetësore. Për këta persona sipas 270 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore të RMV “vërtetimi i vdekjes së tyre bëhet në institutin e lartë nga ana e mjekësisë ligjore ose patologjisë”.²² Vdekja e secilit pacient në institucion shëndetësor patjetër është të jetë e analizuar veçmas në kolegiumin e ekspertëve të institucionit, ku pacienti ka vdekur. Kur bëhet fjalë për personat që vdesin në institucione shëndetësore, përgjegjësia e personelit mjekësor është më e madhe. Është e rëndësishme se personi para vdekjes së tij dhe gjatë qëndrimit të tij në institucionin shëndetësor a ka marrë trajtimin e duhur nga personeli mjekësor.

2.3.1. Përgjegjësia mjekësore

Detyra kryesore e mjekut është që të mbrojtë shëndetin e njerëzve. Dija, njohuritë dhe ndërgjegjja e tij i kushtohet përmbushjes së asaj detyre. Për arsye të mosdijes së mjaftueshme apo veprimeve të pavetëdijshme, mjeku mund të sjellë dëmtime të rënda të

²¹ Po aty, parag. 5.

²² Ligji për mbrojtje shëndetësore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 270.

shëndetit të pacientit të tij, ose të shkaktojë vdekjen, mirëpo ajo ndodh më së shumti pa dashjen e mjekut, gjegjësisht kundrejt dëshirës së tij për të ndihmuar.²³ Detyra e mjekut është gjithmonë të luftojë kundër vdekjes, kundër lëndimit të organizmit. Mjeku nuk ka më detyrim të përkujdeset vetëm për një rreth të caktuar pacientësh, ai duhet në secilën mundësi të punojë në dobi të popullsisë.²⁴

Sipas Ligjit për mbrojtje shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 152: “Punëtori shëndetësor mban përgjegjësi etike, profesionale dhe materiale, ndërsa institucioni shëndetësor e siguron përgjegjësinë e punëtoreve shëndetësorë për dëmin të cilin mund ta shkaktojë gjatë kryerjes së shërbimit shëndetësor”.²⁵ Mjekët përgjigjen edhe penalisht. Raportet mjeko-ligjore sipas kodit penal, konceptet themelore juridike-penale janë: vepra penale, fajësia dhe dënimi.²⁶ Për përgjegjësi penale, thuhet se kryesi do të jetë penalisht përgjegjës në qoftë se ka pasur pakujdesi, apo që ka kryer veprën penale me qëllim ose nga paaftësia.²⁷ Mjekët përgjigjen penalisht edhe në qoftë se kanë qenë të pakujdesshëm gjatë mjekimit të pacientit. Sipas kodit penal të RMV neni 270 mjekim i pakujdesshëm i të sëmurit nënkupton: mjeku i cili gjatë dhënies së ndihmës mjekësore qartë aplikon mjete të papërshtatshme; mënyrë të papërshtatshme të mjekimit; apo nuk aplikon mjete të përshtatshme higjienike, apo vepron fare i papërgjegjshëm dhe me të shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të ndonjë personi do të dënohet me 3 vite burgim. Gjithashtu përfshihen edhe mamitë (gra të moshuara në rolin e mjekes/ motrës medicinale) apo punëtorët e tjerë shëndetësore, të cilët gjatë dhënies së ndihmës apo mbikëqyrjes shëndetësore veprojnë në mënyrë të papërshtatshme dhe me atë shkakton përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të ndonjë personi.²⁸ Në Ligjin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut ekziston një nen i cili ka të bëjë me mosofrimin e ndihmës, i cili thotë: “Ai i cili nuk i ofron ndihmë personit i cili ndodhet në rrezik jete, dhe atë ka mundur ta bëjë pa rrezik për veten e tij apo të dikujt tjetër, do të dënohet me burg deri në 1 vit”.²⁹ Po në atë ligj është rregulluar edhe mosofrimi i ndihmës nga ana e mjekëve. Dënimi është deri në 1 vit

²³ K. Boshkovski, “Medicinska Etika i Deontologija”, Shkup, 2007, fq. 124.

²⁴ Po aty, fq. 127.

²⁵ Ligji për mbrojtje shëndetësore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 152.

²⁶ K. Boshkovski, “Medicinska Etika i Deontologija”, Shkup, 2007, fq. 132.

²⁷ Po aty, fq. 133.

²⁸ Kodi penal i RMV, neni 207.

²⁹ Po aty, neni 136 (Cito si duhet).

burg për mjekët të cilët në kundërshtim me detyrimin e tyre mjekësore refuzojnë t'i ofrojnë ndihmë mjekësore personit, i cili është në rrezik jete. Në qoftë se po ai person vdes, atëherë dënimi është nga 6 muaj deri në 5 vite burg.³⁰ Mosofrimi i ndihmës mjekësore nuk nënkupton vetëm refuzim për intervenim mjekësor, por edhe shmangie diskrete dhe marrëdhënie pasive me pacientin. Në ato raste kur dyshohet se vdekja e pacientit ka ndodhur nga papërgjegjësia mjekësore atëherë në ekspertizat, pas ankesës për mjekim të papërshtatshëm, është e nevojshme detalisht të shqyrtohet rasti dhe të sigurohen të gjitha faktet relevante të akuzës të cilat janë në përmbajtje të rrethanave të cilave është zhvilluar intervenimi mjekësor. Me kërkesë të gjykatës si dhe të personave, të cilët kanë interes juridik për zbardhjen e së vërtetës, gjykata vendos se trupi i pajetë do të dërgohet apo jo për obduksion.

2.4. Obduksioni (Autopsia)

Autopsia është studimi dhe diagnoza e sëmundjes përmes ekzaminimit të organeve, indeve, lëngjeve, trupore dhe organet e tjera (patologjia). Në patologji dallojmë tri metoda kryesore:

Obduksioni nënkupton prerjen e kufomës për të hulumtuar shkakun e vdekjes së tij. Obduksioni mund të jetë në dy lloje: obduksion klinik, i cili bëhet te njerëzit që kanë vdekur nga sëmundja natyrale apo vdekje natyrale; obduksioni mjeko-ligjor, i cili bëhet te njeriu që ka vdekur nga vdekja e dhunshme apo e dyshimtë.

Përgjegjësia penale, juridike dhe disiplinore e mjekëve ekspertë është e kufizuar dhe për atë arsye vlerat e tij etike duhet të jenë të theksuara shprehimisht në procesin e aktivitetit si ekspert.³¹ Për të ekzistuar dhe për të bërë ekspertizë mjeku-ekspert duhet ta njohë mirë doktrinën mjekësore bashkëkohore dhe gjithashtu duhet të ndjekë dhe trende të caktuara të mendimeve në shkencat juridike. Gjykata është ajo e cila duhet të mbajë llogari për përzgjedhjen e mjekut-ekspert, në procesin e procedurave gjyqësore për arsye se mjeku i cili e ka mjekuar pacientin nuk mund të jetë ekspert i po atij rasti, megjithatë mund të dëgjohet vetëm si dëshmitar. Gjyqtari i aftë e di se cili mjek-ekspert jep mendime ekzakte dhe të vërteta të cilat i mundësojnë gjyqtarit që me sukses të zgjidhë rastin. Mjeku ekspert para se

³⁰ Po aty neni, 208.

³¹ K. Boshkovski, "Medicinska Etika i Deontologija", Shkup, 2007, fq. 104.

të japë ekspertizën, duhet së pari: të studiojë mirë lëndën në ekspertizë; në pyetjet e parashtruara nga gjykata të japë përgjigje konkrete, ekzakte, decide dhe të qarta në bazë të fakteve të vërtetuara; nëse nuk ekzistojnë fakte të mjaftueshme të kërkojë nga gjykata që ato të sigurohen; asnjëherë të kryejë ekspertizë dhe të japë mendim ekspert mbi mjekësinë e pamjaftueshme dhe dokumentacione të tjera; përderisa nuk ka mundësi për ushtrimin e detyrës për mendim ekspert, duhet ta informojë gjykatën. Para gjykatës dhe gjyqtarit, mjeku-ekspert me dinjitet duhet t'i dëgjojë pyetjet e parashtruara nga të gjithë palët në qofte se mund të përgjigjet, ajo duhet të jetë në pajtim me faktet dhe të vërtetën konkrete.³²

Ndonjëherë mjekët në mënyrë të pavetëdijshme gabojnë gjatë interpretimit të konkluzioneve të ekzaminimit mjeko-ligjor. Kodi penal të RMV (neni 367 i cili ka të bëjë me dhënien e dëshmive të rreme) parasheh: “Dëshmitari, eksperti, përkthyesi apo interpretuesi i cili para gjykatës apo në administratë në procedurën e kundërvajtjes apo procedurën disiplinore do të japë dëshmi të rreme do të dënohet deri në 3 vite burg...”³³

2.4.1. Nevoja për obduksion

Sipas Ligjit për mbrojtje shëndetësore të RMV (nenit 275), kur ekziston dyshim apo është më se e dukshme se vdekja nuk ka prejardhje natyrale, trupit të personit të vdekur i bëhet autopsi mjeko-ligjore si dhe ekspertizë mjeko-ligjore nga dy mjekë të mjekësisë. Autopsi mjeko-ligjore bëhet në raste të vrasjes apo dyshimit për vrasje, gjegjësisht vetëvrasje apo dyshimit për vetëvrasje; në raste kur ka djegie në fytyrë të të vdekurit; kur ka dyshim për gabim mjekësor; kur rasti ka domethënie të veçantë për mbrojtje të shëndetit të qytetarëve, gjegjësisht kur atë e kërkojnë për shkaqe të hulumtimeve epidemiologjike, sanitare dhe shkencore; në rast të vdekjes së papritur, kur nuk diket shkaku i vdekjes, është i paqartë apo nuk mund të shpjegohet në mënyrë tjetër, duke përfshirë edhe vdekjen e papritur të foshnjave si dhe në raste kur vdekja ka ndodhur në lidhje me procedurën terapeutike apo diagnostike; vdekja në paraburgim, burg apo pasi është dërguar në polici; kur ka dyshim për vdekje si rezultat i torturës apo veprimeve jonjerëzore; vdekjet lidhur me aktivitetet policore

³² K. Boshkovski, “Medicinska Etika i Deontologija”, Shkup, 2007, fq. 106.

³³ Kodi penal i RM, n. 367.

apo ushtarake; trupat e skeletizuar apo të paidentifikuar dhe kur atë e kërkojnë anëtarët e familjes së ngushtë të personit të vdekur, punëtori mjekësor i autorizuar i cili e ka mjekuar personin e vdekur si dhe personi i autorizuar për kontroll të personave të vdekur.³⁴ Në bazë të Ligjit për mbrojtje shëndetësore ngarkesa për pagesën e kryerjes së autopsisë së personit të vdekur bie mbi fondin, përveç në raste kur autopsia është kërkuar nga ana e anëtarëve të familjes apo nga organet e autorizuar, atëherë ngarkesa për pagesën e autopsisë bie mbi ata të cilët kanë bërë kërkesën për autopsi.

2.5. Fletëlëshimi i personit të vdekur

Për secilin person fizik i cili pranohet në institucion shëndetësor, bëhet raport shëndetësor për arsyen e pranimi, mjekimit si dhe gjendjen shëndetësore të pacientit. Për pacientët, të cilët qëndrojnë për shërim me afatgjatë në institucion shëndetësor në momentin e pranimi për qëndrim hapet histori përkatëse. Pas mbarimit të trajtimit mjekësor dhe lëshimit të tij nga spitali përgatitet fletëlëshimi. Fletëlëshimi jepet në dy raste, kur pacienti pas trajtimit mjekësor lëshohet nga spitali, por edhe në rastet kur pacienti gjatë trajtimit dhe qëndrimit të tij në spital ka ndërruar jetë. Në fletëlëshim shënohen të dhënat personale të pacientit, siç janë: emri, mbiemri, vendbanimi, numri amë si dhe të dhënat e tjera personale. Përveç tyre shënohet edhe shkaku për pranimin në spital, trajtimi i marrë, rezultatet nga trajtimi, ndërsa në rastet kur pacienti ka vdekur, atëherë fletëlëshimi duhet të përmbajë edhe të dhënat mbi shkaqet apo arsyen e cila ka sjellë si pasojë vdekjen. Te personat e vdekur në institucion shëndetësor përveç fletëlëshimit jepet edhe vërtetimi i vdekjes dhe raporti mjekësor për shkaqet e vdekjes (nëse i është bërë autopsi atëherë një kopje nga raporti i autopsisë i bashkëngjitet raportit mjekësor), leje për bartjen e të vdekurit si dhe leja për të varrosur të vdekurin pa të cilët i vdekuri nuk mund të varroset.

2.5.1. Transporti i kufomës nga spitali te familjarët

Pasi të jenë kompletuar të gjitha dokumentet e nevojshme i vdekuri mund t'u dorëzohet familjarëve. Transporti i kufomës nuk mund të bëhet nga çdokush, atë mund ta bëjnë vetëm personat e autorizuar (të licencuar) për bartjen e kufomave. Bartësi i kufomave me

³⁴ Ligji për mbrojtje shëndetësore i RM, n. 275.

posedimin e lejetransportit për transferimin e të vdekurit (në të cilën shënohen të dhënat personale të të vdekurit, siç janë: emri, mbiemri, emri i prindit; data dhe vendi i lindjes; shtetësia; ora, dita, muaji, viti, vendi dhe shteti kur dhe ku ka ndodhur vdekja; arsyeja e vdekjes; në qoftë se personi i vdekur ka qenë apo jo më herët i varrosur; vendi, rrethina, shteti se ku do të transferohet i vdekuri; lloji i mjetit të transportit me të cilën do të transferohet kufoma) fiton të drejtën e transportit të kufomës. Pasi transportuesi i licencuar për kufoma të ketë pranuar dokumentacionin e nevojshëm për transferim atëherë ai mund ta bëjë transportin e kufomës në vendin e caktuar (te familjarët). Familjarët pasi të kenë pranuar kufomën kanë të drejtë për varrimin e tij në mënyrën e tyre (varësisht nga ritet e tyre fetare).

Varrimi i personit të vdekur bëhet pas kalimit të 24-orëve nga ora e vdekjes, mirëpo edhe këtu ka përjashtime në ato raste kur bëhet miratimi nga inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor, varrimi mund të bëhet edhe para kalimit të afatit prej 24-orëve dhe pas kalimit të atij afati.³⁵

2.6. Vdekja e shtetasit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sikurse shtetasit e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe shtetasit e huaj të cilët vdesin në RMV bëhet vërtetimi i vdekjes së tij nga ekspertët e asaj lëmie. Me vërtetimin e vdekjes së tij jepet raport mjekësor, ku shënohen të dhënat personale të të vdekurit, shkaqet e vdekjes, koha e vdekjes, mënyra e vdekjes si dhe të dhëna mbi atë nëse i vdekuri ka qenë i prekur nga ndonjë sëmundje. Në qoftë se kemi të bëjmë me vdekje të dyshimtë, atëherë trupi dërgohet për obduksion (në procedurë të njëjtë sikurse edhe shtetasit e RMV). Pas mbarimit të procedurave të vërtetimit të vdekjes dhe autopsisë (nëse është bërë), trupi i pajetë u dorëzohet familjarëve. Nëse familjarët kërkojnë që kufoma e shtetasit të huaj të bartet në vendin e tij (në shtet tjetër), përveç dokumenteve, siç janë: vërtetimi i vdekjes (pa të cilin i vdekuri nuk mund të varroset), arsyeja e vdekjes, nëse është bërë autopsi raporti i saj, atyre duhet t'u bashkëngjitet edhe lejetransporti (udhëzues-transporti) për transferimin e të vdekurit nga një shtet në një shtet tjetër, e cila përmban të dhënat personale të të vdekurit, shkakun, kohën dhe vendin e vdekjes, në lejen e transportit shënohen edhe të dhënat se

³⁵ Ligji për mbrojtje shëndetësore i RM, neni 273.

nëse i vdekuri ka qenë më herët i varrosur, gjithashtu në lejetransport shënohen edhe të dhënat se për ku transferohet kufoma, vendi, shteti, rrethina; mjeti dhe mënyra e transportit të kufomës; pika kufitare e daljes nga shteti; mënyra e vërtetimit të identitetit të të vdekurit; numri i miratimit për transferimin e kufomës si dhe cili organ e ka dhënë miratimin, me kërkesë të kujt është bërë miratimi për bartje, në përcjellje të kujt do të bëhet bartja; si dhe duhet të specifikohet nëse arsyeja e vdekjes ka qenë ndonjë sëmundje infektuese apo jo. Ky udhëzues lëshohet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror pas verifikimit të kufomës.³⁶

2.6.1. Leja për bartjen e personit të vdekur në vendin e tij (shtetasit e huaj)

Bartja e personit të vdekur në vendin e tij bëhet në bazë të rregullores për kushtet dhe mënyrën e varrimit, rivarrimit dhe bartjes së trupit të personit të vdekur në RMV. Kjo rregullore sqaron kushtet dhe mënyrën varrimit, rivarrimit dhe bartjes së trupit të pajetë (kufomës) nga shteti ku ka vdekur në shtetin amë. Në bazë të kësaj rregullore bartja e personit të vdekur nga RMV në shtetin tjetër bëhet me arkivol të drurit i cili është i ndërtuar në mënyrë që të mund të jetë plotësisht i mbyllur.³⁷ Si mjete për transport për bartjen e kufomës sipas rregullores konsiderohen mjetet speciale transportuese, të cilat shërbejnë vetëm për bartje të kufomave si dhe mjetet publike transportuese (të cilat kanë vend të posatshëm dhe të përshtatshëm për kufomën), siç janë: autobusi, vetura, kamioni, transporti hekurudhor, si dhe mjetet ajrore. Bartja e kufomës me autobus apo kamion mund të bëhet vetëm nëse në atë automjet njëkohësisht nuk ka udhëtarë apo çfarëdo ngarkese tjetër. Ndërsa bartja e kufomës me transport hekurudhor bëhet vetëm në rastet kur kufoma është infektuar nga sëmundje të rënda ngjitëse apo nga sëmundje e cila ka qenë shkaktare e vdekjes së kufomës dhe atë me vagon (dhomë) special të mbyllur. Kufomat barten me transporte ajrore të rregullta, bëhet vetëm nëpërmjet hapësirave të posaçme për bartje të kufomave.

³⁶ Zakon za sanitarnata I zdrastvenata inspekcija na RM, sl.ves. na RM, br. 71 od 2006.

³⁷ Rregullore për kushtet dhe mënyrën e varrimit, zhvarrimit dhe bartjes së trupit të vdekur, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21, shkurt 2008.

KAPITULLI III

3. PROCEDURA E TRASHËGIMISË

3.1. Nocioni dhe parimet e së drejtës trashëgimore

E drejta trashëgimore si institut i së drejtës civile, lindi me ndarjen e shoqërisë në klasa, me lindjen e pronës private si nevojë për t'ua lënë trashëgim këtë pasuri fëmijëve. Lidhur me nocionin apo kuptimin e të drejtës trashëgimore në teori nga autorë të ndryshëm jepen përkufizime të ndryshme, por pa dallime të mëdha. E drejta e trashëgimisë mund të përkufizohet se është kalimi midis të drejtës pasurore dhe asaj familjare. Në aspektin e lidhshmërisë me të drejtën pasurore nënkuptojmë kalimin e pasurisë së një subjekti në rast të vdekjes së tij në persona të tjerë, ndërsa me të drejtën familjare nënkuptojmë atë se pozita e trashëgimtarit në mungesë të testamentit përcaktohet sipas shkallës së afërsisë me trashëgimlënësin. E drejta e trashëgimisë është pjesë e së drejtës private me të cilën rregullohen marrëdhëniet juridike, të cilat nuk shuhen me vdekjen e personave fizikë.³⁸

E drejta trashëgimore mund të përkufizohet edhe si degë e së drejtës dhe pjesë e sistemit juridik me të cilën rregullohen marrëdhëniet pasurore-juridike titullarët e këtyre të drejtave dhe bartjen apo kalimin e këtyre të drejtave në trashëgimtar.³⁹

E drejta trashëgimtare rregullon kalimin e të drejtave pasurore dhe eventualisht të drejtave të tjera nga trashëgimlënësi në trashëgimtar në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit.⁴⁰

Pjesa më e madhe e autorëve kur është në pyetje kuptimi i të drejtës trashëgimore pajtohen me nocion tredimensional të së drejtës trashëgimore dhe atë në kuptimin objektiv, subjektiv dhe shkencor.

E drejta trashëgimore në kuptimin objektiv nënkupton tërësinë e normave juridike të cilat rregullojnë trashëgiminë, përkatësisht marrëdhënien trashëgimore-juridike d.m.th. tërësinë

³⁸ Oliver Autic, "Nasledno pravo", Beograd, 2004, fq. 8.

³⁹ Mile Vasilijev, "Nasledno pravo", Shkup, 1983, fq. 13.

⁴⁰ B. Stojavoic-Antic, "Uvod u gragansko pravo", Beograd, 2001, fq. 16.

e normave juridike me të cilat rregullohet kalimi-bartja e pasurisë së një personi në rast të vdekjes së tij në persona të tjerë, trashëgimtarët e tij.⁴¹

E drejta trashëgimore në kuptimin subjektiv nënkupton të drejtën e një apo më shumë personave që të paraqiten në cilësinë e trashëgimtarit lidhur me pasurinë e caktuar trashëgimore në momentin e caktuar.⁴²

E drejta trashëgimore në kuptimin e disiplinës shkencore nënkupton tërësinë e njohurive apo të studimeve të cilat i referohen marrëdhënieve trashëgimore juridike.

3.1.1. Parimet e së drejtës trashëgimore

Në të drejtën trashëgimore si degë të veçantë të së drejtës ekzistojnë parimet themelore në bazë të cilave bëhet rregullimi juridik i marrëdhënieve të trashëgimisë. E drejta trashëgimore ekziston në të gjitha sistemet juridike, por baza dhe parimet mbi të cilat është ngritur ajo dallojnë si në aspektin historik ashtu dhe në atë krahasues.

Përkundër dallimeve parimet janë ato që shërbejnë si bazë dhe bëjnë të dallohet e drejta trashëgimore nga degët e tjera të së drejtës. Në përgjithësi nga autorë të ndryshëm theksohen këto parime:⁴³

- Parimi i sukcesionit universal,
- Parimi i sukcesionit singular,
- Parimi i barazisë së trashëgimtarëve,
- Parimi i ndalimit të marrëveshjes si bazë për trashëgim,
- Parimi i kufizimit të disponimeve me testament,
- Parimi i paralelizimit të bazës së thirrjes në trashëgim,
- Parimi i realizimit të së drejtës së trashëgimisë sipas fuqisë së ligjit,
- Parimi i kufizimit të përgjegjësisë në trashëgimtar,
- Parimi i oficialitetit scesor,
- Parimi i pranimit të trashëgimisë me vullnet (e drejta e heqjes dorë nga trashëgimia),

⁴¹ A. Aliu, Rr. Qehaja, “E drejta trashëgimore” Prishtinë, 2007, fq. 12.

⁴² M. Vasiljev, vep. E cit., fq. 12.

⁴³ M. Vasiljevic, vep. E cit., fq. 76-80 dhe O. Antic vep. E cit., fq. 18-31.

– Parimi i kaducitetit.

Parimi i sukcesionit universal – Ky parim ka të bëjë me atë që disa të drejta dhe detyrime përkundër vdekjes së trashëgimlënësit ato kalojnë në trashëgimtar.

Parimi i sukcesionit singular - nënkupton mundësinë që trashëgimlënësi, personit të caktuar t'i kalojë në trashëgimi një send të caktuar, dhe në këtë rast ky konsiderohet legatar ose suksesor singular (I veçantë). Parimi është se suksesori singular nuk përgjigjet për borxhet e trashëgimlënësit.⁴⁴ Mirëpo kreditorët e trashëgimlënësit kanë përparësi në përmbushjen e kërkesave para legatave.

Parimi i barazisë së trashëgimtarëve - Ky parim paraqet një ndër parimet fundamentale të së drejtës dhe është një nga standardet moderne të sanksionuara me normë të brendshme dhe ato ndërkombëtare. Kjo barazi ka të bëjë me mosdiskriminimin gjinor dhe çdo formë tjetër të diskriminimit përfshirë atë në mes të fëmijëve martesorë dhe jashtëmartesorë, të adoptuar dhe natyrorë.

Parimi i ndalimit të marrëveshjes si bazë për trashëgim - sipas këtij parimi ndalohet çfarëdo marrëveshje paraprake e cila ka për qëllim ndarjen e pasurisë trashëgimore pa plotësimin e kushteve të parapara me dispozita ligjore.

Parimi i kufizimit të disponimeve me testament - ky parim është një ndër parimet më të vjetra në të drejtën e trashëgimisë dhe është i njohur edhe nga e drejta romake. Sipas këtij parimi e drejta në hartimin e testamentit është e drejtë e kufizuar që do të thotë se testamentlënësi me rastin e hartimit të testamentit nuk ka të drejtë absolute të veprëjë sipas dëshirës së tij duke cenuar pjesën e domosdoshme të trashëgimtarëve.

Parimi i paralelizmit të bazës së thirrjes në trashëgim - Sipas këtij parimi nëse trashëgimtari në cilësi të trashëgimtarit universal trashëgon pasurinë trashëgimore sipas bazës ligjore të testamentit, i njëjti nuk mund të trashëgojë edhe sipas bazës së ligjit pasurinë e njëjtë dhe anasjelltas.

⁴⁴ Ligji për trashëgimi të Kosovës 2005, neni 122, paragrafi 1.

Parimi i realizimit të së drejtës së trashëgimisë sipas fuqisë së ligjit - Sipas këtij parimi buron se deklarata për pranimin e cilësisë së trashëgimtarit të pasurisë trashëgimore të cilën e ka lënë pas vete trashëgimlënësi ka karakter deklarativ e jo karakter konstituiv.

Parimi i kufizimit të përgjegjësisë në trashëgimtar - me rastin e vdekjes së trashëgimlënësit, në trashëgimtar bëhet kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve me përjashtime të caktuara të të drejtave dhe detyrimeve me karakter personal.

Parimi i oficialitetit - ky parim në të kaluarën e tij historike lidhet me sistemin e mesjetës dhe reflektohet në interesimin e shtetit që të vjelë të hyra nga tatimet e dedikuara me rastin e kalimit të pasurisë së trashëgimit.

Parimi i pranimit të trashëgimisë me vullnet (e drejta e heqjes dorë nga trashëgimia) - nënkupton se trashëgimtari nuk mund të detyrohet të marrë pjesën trashëgimore, as atë ligjore dhe as atë testamentale kundër dëshirës së tij.

Parimi i kuadicitetit⁴⁵ - Me parimin e kuadicitetit kuptohet fakti juridik se trashëgimlënësi pas vdekjes së tij nuk ka trashëgimtar e quhet kadukna,⁴⁶ që do të thotë pasuri pa trashëgimtar. Pasuria pa trashëgimtar konsiderohet ajo pasuri e cila nuk mund të bartet te trashëgimtarët për shkak se ato nuk ekzistojnë ose për shkak se nuk janë të aftë për të trashëguar apo kanë hequr dorë nga trashëgimia.

3.2. Kategoritë themelore të së drejtës trashëgimore

Varësisht nga sistemi juridik për të cilin bëhet fjalë, kategoritë themelore të së drejtës trashëgimore mund të jenë të ndryshme.

Në kuadër të kategorive themelore të së drejtës së trashëgimisë bëjnë pjesë:

- Vdekja e trashëgimlënësit,
- Pasuria trashëgimore,
- Ekzistimi i trashëgimtarëve,
- Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve,

⁴⁵ Shprehje e përdorur nga Verdis, M. dhe Kralic, P. *Gragjansko Pravo*, Zagreb, 2003, fq. 655.

⁴⁶ Verdis, M. dhe Karlic, P. vep. E cituar fq. 655.

- Paaftësia për trashëgim,
- Baza juridike e thirrjes në trashëgim.⁴⁷

Vdekja e trashëgimlënësit - Vdekja është ajo e cila hap rrugën për të trashëguar. Fenomeni i vdekjes interpretohet si një fakt juridik kompleks, por është ai i cili hap rrugën për shqyrtimin e pasurisë së trashëgimisë. Vdekja duhet të jetë faktike që nënkupton pushimin e të gjitha funksioneve vitale të njeriut sepse shkenca e mjekësisë njeh edhe vdekjen klinike që për të drejtën trashëgimore është irelevante. Të njëjtin efekt ka edhe shpallja e personit të zhdukur për të vdekur. Si pasojë e vdekjes shuhen disa të drejta dhe detyrime jopasurore: si të drejtat dhe detyrimet familjare, të drejtat e personalitetit ose të drejtat personale në kuptimin më të ngushtë. Këto janë të drejta objekt i të cilave është prona personale,⁴⁸ nëpërmjet të cilave shprehet liria dhe integriteti fizik moral, shpirtëror dhe ideor.

Pasuria trashëgimore - është kusht themelor për krijimin e marrëdhënieve juridike të trashëgimisë.

Në kuptimin e përgjithshëm me shprehjen pasuri kuptojmë tërësinë e të drejtave civile subjekteve të karakterit pasuror, të cilat i takojnë një subjekti apo një tërësie të caktuar të subjekteve juridike.⁴⁹ Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit në trashëgimtar kalojnë të drejtat e tij të karakterit pasuror. Duke pasur parasysh se dhe të drejtat pasurore janë të lidhura ngushtë me titullarin e tyre, kjo apriori nuk nënkupton se me vdekjen e titullarit shuhet edhe të gjitha të drejtat që ka pasur ai, përkundrazi ato vazhdojnë jetën e tyre në titullarë të rinj. Në përbërjen e pasurisë së trashëgimit hyn të gjitha të drejtat e karakterit real si e drejta e pronësisë, servitutet,⁵⁰ të karakterit detyrimor si kontrata të ndryshme, shpërblimi i dëmit,⁵¹ të karakterit të së drejtës së autorit⁵² dhe pronësisë industriale.

Në përbërjen e pasurisë trashëgimore nuk bëjnë pjesë ato të drejta pasurore të lidhura ngushtë me personalitetin e trashëgimlënësit, si: servitutet personale, autorizimi etj.

⁴⁷ A. Aliu, Rr. Qehaja, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2007, fq. 37.

⁴⁸ A. Gams, "E drejta civile", fq. 170.

⁴⁹ A. Aliu, vep. e cit. (dorëshkrim), fq. 154.

⁵⁰ A. Aliu, "E drejta sendore-pronësia", Prishtinë, 2006.

⁵¹ Nerxhivane, Dauti, "E drejta e detyrimeve", Prishtinë, 2004.

⁵² A. Aliu, "E drejta e autorit", Prishtinë, 2004.

Ekzistimi i trashëgimtarëve - Statusin për të qenë trashëgimtar nën kushte të caktuara mund të fitonte çdo person fizik përfshirë edhe skllevërit në kohën e Perandorisë Romake.⁵³ Sot pjesa më e madhe e legjislacioneve cilësinë e trashëgimtarit si atij universal, ashtu edhe singular i njohin si personave fizikë ashtu edhe atyre juridikë nën kushte të caktuara.

Nëse pas vdekjes së trashëgimlënësit ekziston vetëm një trashëgimtar, atëherë ai në mënyrë të përgjithshme trashëgon të gjithë pasurinë trashëgimore.

Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve - Përveç kushteve të përgjithshme që duhet plotësuar në mënyrë që një person të këtë cilësinë e trashëgimtarit ndër të tjera kërkohet që ai të jetë i denjë për trashëgim.

Të padenjë për të trashëguar si nga ligji, ashtu edhe nga virtyti i një testament, si dhe marrjen e diçkaje të bazuar në një testament janë ata të cilët:

- 1) me qëllim e privon nga jeta trashëgimlënësin apo ka tentuar që ta privojë;
- 2) me detyrim ose kanosje apo me mashtrim, e ka detyruar trashëgimlënësin ta bëjë apo ta revokojë testamentin ose të pengojë atë që ta bëjë atë;
- 3) ka shkatërruar apo fshehur testamentin nga trashëgimlënësi me qëllim që ta pengojë atë për ta realizuar vullnetin e fundit të trashëgimlënësit, si dhe ai i cili ka falsifikuar testamentin e trashëgimlënësit;
- 4) ka shkelur rëndë detyrimin për ushqim të trashëgimlënësit ndaj të cilit kishte detyrim ligjor për mbajtje, si dhe ai që nuk ka dashur t'i ofrojë ndihmë të nevojshme trashëgimlënësit.⁵⁴

Paaftësia për të trashëguar - me paaftësinë për trashëgimi kuptojmë marrjen e mundësisë një kategorie të personave që të jenë trashëgimtarë të pasurisë trashëgimore, pa marrë parasysh bazën e thirrjes në trashëgim dhe marrëdhëniet e tyre me trashëgimlënësin.

Me fjalë të tjera paaftësia për trashëgim ekziston atëherë kur një person edhe pse është subjekt i së drejtës dhe në bazë të kësaj eventualisht mund të jetë pjesëmarrës në raportet e tjera juridike nuk mund të jetë trashëgimtar në një shtet pa marrë parasysh se kush

⁵³ Ivo, Puhani, "E drejta romake", Prishtinë, 1989, fq. 407.

⁵⁴ "Zakon za nasledovanje" na RSM, Redakciski precisten tekst, sl. ves. na RM.

paraqitet si trashëgimlënës për shkak të ekzistimit të disa rrethanave në anën e këtyre personave pa fajin e tyre, por pse ashtu konsiderohen nga shteti.⁵⁵

3.3. Radhët e trashëgimisë sipas Ligjit për trashëgimi të RMV

Të vdekurin e trashëgojnë të gjithë paraardhëset e tij, të birësuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshortja e tij, prindërit e tij, prindërit e tij birësues, motrat dhe vëllezërit e tij dhe pasardhësit e tyre, dhe të gjithë gjyshërit dhe pasardhësit e tyre.⁵⁶ Këta persona trashëgojnë sipas vijave trashëgimore. Trashëgimtarët nga linja më e afërt e trashëgimisë i përjashtojnë nga trashëgimia personat nga linja trashëgimore më e largët.

Trashëgimia e trashëgimlënësit trashëgohet në radhë të parë nga fëmijët dhe bashkëshorti/bashkëshortja. Ata trashëgojnë pjesë të barabarta. Si p.sh.

25% bashkëshort	25% vajza	<i>Ata trashëgojnë pjesë të barabarta</i>
25% djali	25% vajza	

Në qoftë se ka vdekur ndonjëri nga pasardhësit të radhës së parë të trashëgimlënësit, atëherë të drejtën e trashëgimisë e trashëgojnë paraardhësit e tij në qoftë se ata ekzistojnë.

Në rast kur trashëgimlënësi nuk ka pasardhës, atëherë trashëgimia do të ndahet në radhë të dytë ndërmjet bashkëshortit dhe prindërve të trashëgimlënësit. Gjysma e trashëgimisë prindërve dhe gjysma tjetër bashkëshortit. Në qoftë se prindërit nuk i ka të gjallë, atëherë e gjithë trashëgimia i takon bashkëshortit.

Në radhë të tretë të trashëgimisë në Ligjin për trashëgimi të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë gjyshërit e trashëgimlënësit.

⁵⁵ B. Blagojevic, Vep. e cit. fq. 27-28.

⁵⁶ "Zakon za nasledovanje" na RSM, Redakciski precisten tekst, sl. ves. na RM clen 14.

3.3.1. Dispozitat e veçanta për disa trashëgimtarë

Është rregull e përgjithshme madje edhe e sanksionuar me norma kombëtare dhe ndërkombëtare mbi barazinë dhe trajtimin e barabartë të të gjithë fëmijëve pa asnjë dallim. Ky parim duhet të shërbejë si parim bazë edhe me rastin e ndarjes së pasurisë trashëgimore, përkatësisht kalimit të saj nga trashëgimlënësi në trashëgimtar.

Në Ligjin e të drejtës trashëgimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të definuar dispozita të veçanta për të adaptuarit, kur partneri bashkëshortor e humb të drejtën e trashëgimisë dhe kur përfiton të drejtën e zmadhimit të pjesës trashëgimore, zmadhimet e trashëgimisë së prindërve, personave të cilët kanë jetuar në një bashkësi. Gjithashtu me ligj janë të paraparë dhe trashëgimtarët e domosdoshëm si dhe kushtet të cilat duhet plotësuar ata që të mund të llogaritet nga radhët e trashëgimtarëve.

3.4. Testamenti dhe revokimi

Në të drejtën trashëgimore në përgjithësi ekzistojnë dy mënyra të thirrjes në trashëgimi, në bazë të ligjit dhe në bazë të testamentit. Secilit person i është lënë mundësia që të bëjë ndryshimin e radhëve ligjore të trashëgimit nëpërmjet të shprehjes së vullnetit të fundit të tij në kufijtë e lejuar sipas ligjit në fuqi. Nga kjo rrjedh edhe instituti i lirisë së shprehjes së vullnetit të trashëgimlënësit se kujt dëshiron t'ia kalojë pasurinë trashëgimore të njohur me emrin testament.

Testamenti në kuptimin juridik lind të drejta dhe detyrime të caktuara ndaj personave të caktuar dhe këto të drejta dhe detyrime gjithmonë kanë karakter pasuror.

Testament mund të përpilojë çdo person i cili është i aftë të gjykojë dhe ka të mbushur 15 vjet.⁵⁷

Testamenti mund të shpallet edhe i pavlefshëm në qoftë se nuk është i përpiluar në përputhshmëri me dispozitat ligjore, si: nëse personi nuk ka pasur moshën e duhet për ta përpiluar, nuk ka qenë i aftë për të gjykuar në momentin e përpilimit, në rast se testamenti është përpiluar me mashtrim, lajthim, apo nën kërcënim.

⁵⁷ "Zakon za nasleduvanje" na RSM, Redakciski precisten tekst, sl. ves. na RM clen 62.

Testamenti është punë juridike mortis causa (në rast të vdekjes)

Llojet e testamentit janë: testament i shkruar me shkrimin e tij, testamenti gjyqësor, testament i përpiluar në gjendje lufte, testament ndërkombëtar, si dhe testamenti gojor.

3.4.1. Revokimi i testamentit

Testamenti përbën një veprim juridik të njëanshëm, me anë të së cilit trashëgimlënësi disponon pasurinë e tij pas vdekjes, deri sa të jetë ky gjallë mund të revokohet tërësisht ose pjesërisht nga trashëgimlënësi në çdo kohë. Edhe revokimi si edhe testamenti përbën një veprim juridik të njëanshëm, që do të thotë varet nga vullneti i testatorit. Që ky veprim të ketë efekte juridike natyrisht që duhen plotësuar kushtet e përgjithshme në drejtim të zotësisë së veprimit, përndryshe veprimet e ndërmarra do të konsiderohen nule.

Trashëgimlënësi mund të revokojë testamentin kurdoherë në tërësi apo pjesërisht në njërin nga format e parapara me ligj për përpilimin e testamentit. Testamenti revokohet me një testament të dytë, që për nga forma ky i fundit mund të jetë një testament olografik ose një testament me akt noterial.

KAPITULLI IV

4.1. Procedura e Gjykatës për trashëgimi pas pranimit të aktvdekjes

Pas vdekjes së personit, fillon një etapë tjetër që lidhet me trashëgiminë e tij, realisht që të dihet saktë se kush është trashëgimtar i trashëgimlënësit si dhe cila është baza për thirrje në trashëgimi. Në kuadër të kësaj mund të potencojmë që ekzistojnë dy baza për thirrje në trashëgimi dhe atë trashëgimi në bazë ligjore dhe trashëgimi në bazë të testamentit.

Në bazë të kësaj, pas pranimit të aktvdekjes, me të cilën vërtetohet vdekja e subjektit të caktuar, gjyqi së pari provon kompetencat e veta për shqyrtimin e trashëgimisë, që i bie shikon lidhur me faktin se a është kompetent për ta shqyrtuar trashëgiminë e atij subjekti dhe pasi të përcaktojë kompetencën ose moskompetencën e tij, atëherë kalohet në pjesën e shqyrtimit të trashëgimisë. Pra, në fillim duhet të bëhet vërtetimi, realisht provimi i kompetencës për shqyrtimin e trashëgimisë dhe vetëm pasi të provohet që gjykata në fjalë është kompetente për shqyrtimin e trashëgimisë, atëherë fillon me shqyrtimin e trashëgimisë.

Në ligj potencohet që:

*“Pas aktvdekjes, gjykata së pari provon kompetencat e veta për shqyrtimin e trashëgimisë. Nëse gjykata konstaton se është jokompetent për shqyrtimin e trashëgimisë, aktvdekjen dhe shkresat e tjera do t’ia dorëzojë gjykatës kompetente. Nëse gjykata konstaton se për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetent organi i huaj, me aktvendim do të shpallet për jokompetent”.*⁵⁸

Në kuadër të kësaj norme juridike përcaktohet qartë se në fillim duhet të bëhet vërtetimi i kompetencës së gjykatës. Në rast se ajo është kompetente atëherë vazhdohet me shqyrtimin e trashëgimisë, mirëpo në rast se ajo nuk është kompetente në rastin e tillë, atëherë duhet që të gjitha aktet duke përfshirë këtu aktvdekjen dhe shkresat e tjera duhet që në afat të arsyeshëm t’ia dorëzojë gjykata kompetente. Pra, në rastin e tillë dokumentet i dërgon tek organi kompetent për shqyrtimin e trashëgimisë.

⁵⁸ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Neni 161.

Në rast se gjyqi konstaton se për shqyrtimin e trashëgimisë nuk është kompetent as gjykata në fjalë e as ndonjë gjykatë tjetër në vendin tonë, por është ndonjë gjykatë tjetër e huaj, në ato raste gjykata para të cilës është shtruar lënda me aktvendim do të shpallet jokompetente. Pra, akti i cili e vërteton jokompetencën e lëndës në fjalë është aktvendimi.

Gjatë këtij procesi, të rëndësishëm, shohim që gjykata me kujdes dhe në mënyrën më të mirë të duhur zgjidh çështjet dhe mban përgjegjësi për kompetencën ose jokompetencën e saj. Pas vërtetimit të kompetencës së gjykatës atëherë ajo mund të urdhërojë masa për sigurimin e trashëgimisë dhe këtë e bënë gjatë tërë procesit ose procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë. Lidhur me këtë bazohemi te ligji në të cilin thuhet:

“Gjykata për trashëgimi mund të urdhërojë masa për shqyrtimin e trashëgimisë gjatë tërë procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë.”⁵⁹

Gjëja që është mjaft e rëndësishme është fakti që cekëm edhe më herët lidhur me bazat e thirrjes në trashëgimi. Në kuadër të kësaj ligjdhënësi qartë përcakton se ekzistojnë dy baza të thirrjes në trashëgimi dhe atë:

- *Trashëgimi në bazë ligjore,*
- *Trashëgimi në bazë të testamentit.*

Mjaft e rëndësishme është të kemi të qartë se momenti i vdekjes i një subjekti, personi fizik, me vete shkakton edhe prodhon efekte të caktuara juridike, pra realisht lindin punë të tjera të cilat shkaktohen vetëm pas vdekjes së një subjekti e të cilët njihen si punë juridike pas vdekjes (mortis causa).

Sa i përket mënyrës së trashëgimisë, ajo që është e rëndësishme është fakti se trashëgimia në bazë ligjore është trashëgimi ku në ligj përcaktohen qartë radhët e trashëgimisë dhe kjo vjen në shprehje në ato raste kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament lidhur me trashëgiminë e tij. Pra, mungesa e testamentit paraqet nevojën e përcaktimit të trashëgimisë sipas radhëve të trashëgimisë të cilat janë të përcaktuara qartë me ligj.

Trashëgimia në bazë të testamentit është e kundërta e trashëgimisë ligjore, pasi këtu trashëgimtarët nuk trashëgojnë në bazë të ligjit, por trashëgojnë në bazë të testamentit,

⁵⁹ Po aty, Neni 162

gjithsesi duke qenë në harmoni dhe në përputhje me ligjin, mbase në rast të mospërbushjes së elementeve të duhura të cilat kërkohen te testamenti e bëjnë që ai testament të mos prodhojë efekte juridike. Pra, testamenti është akt rigoroz, i njëanshëm me të cilin trashëgimlënësi, përcakton trashëgimtarët e tij sipas bindjes së tij, por edhe duke pasur parasysh elementet ligjore të cilat kërkohen që të plotësohen që të mund të jetësohet ai testament pas vdekjes së subjektit në fjalë. Testamenti assesi nuk mund të hapet para vdekjes së subjekti, por i njëjti mund të hapet vetëm pas vdekjes së subjektit dhe vetëm atëherë mund të kërkohet zbatimi edhe implementimi i të njëjtit.

Një gjë mjaft e rëndësishme është fakti që, nëse trashëgimlënësi ka emëruar ndonjë subjekt të caktuar si zbatues të testamentit, një subjekt i cili do të bëjë zbatimin e testamentit, gjyqi është i detyruar që për atë punë ta njoftojë atë person, ku realisht në momentin e njoftimit duhet t'i caktojë afat në të cilin subjekti, i cili në rastin konkret në testament paraqitet si zbatues i testamentit, duhet që të prononcohet se a e pranon këtë detyrë apo jo. Kjo duke u bazuar në ligj ku thuhet:

“Nëse trashëgimlënësi ka emëruar zbatues të testamentit, gjyqi është i detyruar për atë ta njoftojë, duke caktuar afat në të cilin ai është i detyruar të prononcohet nëse e pranon atë detyrë”.⁶⁰

Kjo gjithmonë vjen në shprehje në ato raste kur trashëgimlënësi, vullnetin e tij e ka shprehur në bazë të testamentit, ku qartë ka përcaktuar se cili subjekt ose person konsiderohet më adekuat për zbatimin e testamentit, pra në kuadër të kësaj norme juridike kjo vjen në shprehje kur baza për trashëgimi është testamenti, por edhe pse ky person, i cili është emëruar si zbatues i testamentit nga ana e trashëgimtarit, nuk do të thotë që doemos duhet të pranojë dhe ta realizojë këtë detyrë, por duhet fillimisht t'i jepet afat i caktuar kohor që të shihet se a e pranon të njëjtën detyrë, me këtë nënkuptohet se kjo nuk është një normë imperative, por është një normë dispozitive me të cilin subjekti në fjalë mund të pranojë dhe mund të mos e pranojë një detyrë të këtillë, por që është i detyruar të prononcohet lidhur me këtë.

⁶⁰ Ligji për procedurë jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 163.

Gjatë procesit të trashëgimisë, në raste të caktuara si pjesëmarrës ndoshta jo direkt, mund të jetë edhe Qendra për Punë Sociale. Kjo vjen në shprehje në ato rastet kur gjatë procesit të trashëgimisë pritet lindja e fëmijës i cili do të thirrej në trashëgimi, në këto raste gjyqi për trashëgimi, do të thotë që është kompetent për trashëgiminë e caktuar do ta njoftojë Qendrën për Punë Sociale lidhur me këtë që më pas Qendra për Punë Sociale të vlerësojë nëse interesat e tij duhet t'i përfaqësojë prindi ose do të duhet të emërohet ndonjë tutor. Një gjë e tillë rrjedh nga vetë ligji ku theksohet:

“Nëse pritët lindja e fëmijës i cili do të thirrej në trashëgimi, gjyqi për trashëgimi me këtë do ta njoftojë qendrën për punë sociale të vlerësojë nëse interesat e tij duhet t'i përfaqësojë prindi ose do të emërojë tutor. Nëse qendra për punë sociale në afat prej tridhjetë ditësh pas pranimit të njoftimit nuk përcakton ndryshe, për të drejtat e fëmijës së palindur do të kujdeset njëri prej prindërve të tij.”⁶¹

Më pas në ligj përcaktohet edhe afati kohor brenda të cilës Qendra për Punë Sociale duhet të prononcohet lidhur me këtë çështje, gjë që e përmendëm më lart, me të cilën Qendra për Punë Sociale duhet që në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të njoftimit nga ana e Gjyqit dhe nëse brenda këtij afati nuk përcaktohet ndryshe, atëherë sa i përket të drejtave të fëmijës së palindur do të kujdeset njëri prej prindërve të tij.

Në ligj në mënyrë decisive përcaktohet se kur nuk mund të mbahet procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë edhe atë:

“Nëse prej të dhënave nga aktvdekja shihet se i vdekuri nuk ka lënë pronë, gjyqi për trashëgimi do të vendosë që të mos mbahet procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë Gjykata do të vendosë që të mos mbahet procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë edhe kur i vdekuri ka lënë vetëm pronë të tundshme, ndërsa asnjëri nga personat e thirrur në trashëgimi nuk ka kërkuar të mbahet shqyrtim. Kur ndërmjet trashëgimtarëve ka persona të cilët nuk janë të aftë vetë të kujdesen për të drejtat e veta, ndërsa nuk kanë prindër, gjyqi është i detyruar që, kur do të vendosë të mos debatohet për trashëgimin, ta njoftojë për këtë qendrën për punë sociale.”⁶²

⁶¹ Po aty, neni 164, paragrafi 1.

⁶² Ligji për procedurë jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 165.

Nga kjo mund të shohim që jo çdoherë mund të mbahet procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë, mbase në ligj përcaktohen qartë disa raste, ku në rast se të njëjtat ekzistojnë në ato raste do të thotë që nuk mbahet procedurë për shqyrtimin e trashëgimisë, bëhet fjalë për raste të qarta të cilat përmenden edhe më lart në ligj, por që të njëjtat janë si vijon:

- *nëse prej të dhënave nga aktvdekja shihet se i vdekuri nuk ka lënë pronë;*
- *kur i vdekuri ka lënë vetëm pronë të luajtshme, ndërsa asnjëri nga personat e thirrur në trashëgimi nuk ka kërkuar të mbahet shqyrtim;*
- *kur ndërmjet trashëgimtarëve ka persona të cilët nuk janë të aftë vetë të kujdesen për të drejtat e tyre, ndërsa nuk kanë prindër, gjyqi është i detyruar që, kur do të vendosë të mos debatohet për trashëgiminë, ta njoftojë për këtë Qendrën për Punë Sociale.*

4.2. Seanca për shqyrtimin e trashëgimisë

Pasi gjykata pranon aktvdekjen dhe vërteton lidhur me kompetencën e saj që është një element mjaft i rëndësishëm më pas vërteton se nuk ekziston ndonjë nga kushtet për të cilën mund të thirret për mosmbajtje të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, atëherë gjykata thërret seancë për shqyrtimin e trashëgimisë.

“Për shqyrtimin e trashëgimisë gjyqi thërret seancë”.⁶³

Lidhur me atë se kush mund të jetë prezent në seancën që thirret nga ana e gjykatës, në ligj mjaft qartë potencohet që:

“Personat e interesuar thirren në seancë me ftesë”⁶⁴

Pasi këta persona thirren në seancë, gjykata fillimisht i njofton këta persona për ngritjen e procedurës dhe më pas për ekzistimin e testamentit, në rast se i njëjti ekziston. Por, kjo nuk është vetëm thjeshtë njoftim, njëherit gjykata do të thërrasë persona të caktuar që t'i dorëzojnë testamentet me shkrim, po qe se ata kanë diçka të tillë ose dokumente të caktuara për testament gojor, nëse gjendet tek ata.

⁶³ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 167, paragrafi 1.

⁶⁴ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 167, paragrafi 2.

*“Në thirrje gjykata i njofton këta persona për ngritjen e procedurës dhe për ekzistimin e testamentit, nëse i tillë ekziston. Njëkohësisht, me thirrjen gjykata do t’i thërrasë personat të dorëzojnë testamentin me shkrim, përkatësisht dokument për testament gojor, nëse gjendet tek ata”.*⁶⁵

Pas kësaj gjykata do t’i paralajmërojë personat të cilët janë të interesuar se ata kanë kohë që deri në përfundimin e procedurës mund të japin deklarata sa i përket asaj se a e pranojnë trashëgiminë ose heqin dorë nga trashëgimia. Ata kanë mundësi të deklarohen lidhur me këtë, po ashtu në rast se ata nuk vijnë në seancë ose nuk japin deklaratë për të drejtën e tyre do të vendoset në bazë të të dhënave të caktuara.⁶⁶

Gjatë mbajtjes së seancës për shqyrtimin e trashëgimisë po ashtu rregullohen edhe çështje të tjera të rëndësishme, në kuadër të kësaj në rastet kur trashëgimlënësi ka lënë një testament të caktuar, gjykata do t’i thërrasë në seancë edhe ata persona të cilët ndoshta nuk ceken në testament, por të cilët në bazë të ligjit do të mund të kenë të drejtën e trashëgimisë. Pra, këtu gjykata i thërret edhe subjektet të cilët kanë të drejtë në trashëgimi dhe që këtë të drejtë e ua jep ligji, e në rast se i vdekuri ka emëruar zbatues të testamentit, gjykata po ashtu do ta thërrasë edhe atë në seancë. Dispozita ligjore lidhur me këtë çështje thekson:

*“Në rast kur trashëgimlënësi ka lënë testament, gjykata do t’i thërrasë në seancë edhe ata persona të cilët në bazë të ligjit do të mund të kenë të drejtën e trashëgimisë. Nëse i vdekuri ka emëruar zbatues të testamentit, gjyqi do të thërrasë në seancë edhe atë”.*⁶⁷

Pos këtyre rasteve të zakonshme ka raste të caktuara kur gjykata nuk e ka të njohur faktin nëse i vdekuri, pra trashëgimlënësi ka trashëgimtar apo jo dhe në këtë rast gjykata bën shpallje me të cilën i bën thirrje të gjithë personave të cilët realisht kanë të drejtën e trashëgimisë që ata të lajmërohen. Lajmërimi i tyre ka një afat të caktuar kohor, me të cilën nënkuptohet se ata duhet të lajmërohen brenda këtij afati kohor që është një (1) vit nga dita e publikimit të shpalljes, ashtu parashihet edhe në normën juridike:

⁶⁵ Po aty, neni 167, paragrafi 3.

⁶⁶ Po aty, neni 167, paragrafi 4.

⁶⁷ Po aty, neni 167, paragrafi 5 dhe 6.

“Nëse gjykata nuk e ka është e njoftuar se i vdekuri ka apo jo trashëgimtar, atëherë me shpallje, do t’i thërrasë personat të cilët kanë të drejtën e trashëgimisë të lajmërohen në afat prej një viti nga dita e publikimit të shpalljes”.⁶⁸

Sa i përket shpalljes ajo publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe po ashtu e njëjta vendoset në tabelën për shpallje të gjykatës dhe kjo ndodh normalisht që subjektet të mund të informohen më lehtë që njëkohësisht të paraqiten brenda afatit të paraparë kohor.

“Shpallja publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe vendoset në tabelën për shpallje të gjykatës”.⁶⁹

Ajo që është e rëndësishme është fakti se në të njëjtën mënyrë gjyqi do të veprojë edhe kur trashëgimtarit i është vënë tutor i përkohshëm për shkak se nuk është i njohur vendbanimi i tij, përkatësisht, vendqëndrimi, pra nuk e dimë vendin ku trashëgimtari banon apo qëndron për momentin dhe si pasojë e kësaj vendoset nën tutor dhe pos kësaj nuk ka përfaqësues të vet, si dhe atëherë kur trashëgimtari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk ndodhen në vendin tonë, por ndodhen jashtë vendit dhe prapë nuk ka ndonjë person si përfaqësues të vet, ashtu që dorëzimi nuk mund të kryhet dhe kjo duke u bazuar në normën juridike:

“Në të njëjtën mënyrë gjykata do të veprojë edhe kur trashëgimtarit i është vënë tutor i përkohshëm për shkak se nuk është i njohur vendbanimi i tij, përkatësisht vendqëndrimi, ndërsa ai nuk ka përfaqësues të vet, si dhe atëherë kur trashëgimtari ose përfaqësuesi i tij ligjor ndodhen jashtë vendit, ndërsa ai nuk ka përfaqësues të vet, ashtu që dorëzimi nuk ka mundur të kryhet”.⁷⁰

Një gjë e cila ka një rëndësi të veçantë është fakti se çka do të ndodhë po qe se nuk lajmërohet asnjë person dhe nuk japin deklaratën e nevojshme brenda afatit kohor pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut? Cilat janë veprimet e gjykatës më pas?

⁶⁸ Po aty, neni 168, paragrafi 1.

⁶⁹ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 167, paragrafi 2.

⁷⁰ Po aty, neni 168, paragrafi 3.

Kuptohet që ligjdhënësi ka paraparë edhe një mundësi të këtillë, ku në dispozitën ligjore e ka potencuar në mënyrë të qartë:

“Pas skadimit të afatit prej një viti nga shpallja në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nëse personat e interesuar nuk lajmërohen dhe nuk e japin deklaratën e nevojshme, gjykata do ta shqyrtojë trashëgiminë në bazë të deklaratës së tutorit dhe të dhënave me të cilat disponon”.⁷¹

Në këtë normë juridike parashihet qartë se ka mundësi që të ndodhin raste të tilla ku personat e interesuar nuk lajmërohen dhe më pas gjykata do ta shqyrtojë trashëgiminë në bazë të deklaratës së tutorit dhe të dhënave që ka ai, pra afati i paraparë kohor është afat prekluziv me të cilën palët e interesuar duhet të paraqiten dhe të lajmërohen, por në rast se ato nuk paraqiten në ato raste gjykata do ta shqyrtojë trashëgiminë në bazë të deklaratës dhe të dhënave të tutorit.

Sa i përket asaj se ku mund të jepet deklaratë për trashëgimi, kjo gjë po ashtu është e specifikuar në normën juridike:

“Deklarata për trashëgimi jepet para gjykatës për trashëgimi, ndërsa mund të jepet para çdo gjykate tjetër themelore, ndërsa jashtë vendit deklarata për trashëgimi jepet para përfaqësive diplomatike – konsullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose para organit të autorizuar të shtetit të huaj.”⁷²

Në këtë normë juridike shohim që deklaratën për trashëgimi subjektet mund t’i japin para gjykatës për trashëgimi, si gjykatë parësore në rastin konkret, mirëpo e njëjta mund të jepet para çdo gjykate tjetër themelore. Subjektet kanë të drejtën sa i përket dhënies së deklaratës për trashëgimi. Në tërësi kjo vlen për subjektet të cilët janë brenda territorit të shtetit. Mirëpo, për ato që janë jashtë shtetit deklarata për trashëgimi jepet para përfaqësive diplomatike – konsullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose para ndonjë organi të autorizuar të shtetit të huaj. Me këtë nënkupton se subjektet qofshin brenda vendit apo qofshin jashtë vendit kanë mundësi që deklaratën për trashëgimi ta japin në organe të caktuara me ligj.

⁷¹ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 168, paragrafi 4.

⁷² Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 169, paragrafi 1.

Sa i përket procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë, këtui ligji i mundëson që trashëgimtari të mund të deklarohet lidhur me pranimin ose mospranimin e trashëgimisë. Pra, ai ka të drejtë që ta pranojë të njëjtën ose të heq dorë nga trashëgimia. Kjo ngelet në vullnetin e tij të lirë.

“Trashëgimtari me deklaratën për trashëgimi mund të pranojë trashëgiminë ose të heq dorë nga trashëgimia”.⁷³

Në rastet kur personi nuk dëshiron që ta pranojë trashëgiminë, në fakt bënë deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia, kjo realizohet me një formë të caktuar. Kjo nënkupton se kjo deklaratë jepet në procesverbal para gjykatësit, këtui po qe se bëjmë fjalë për subjekte të cilët janë brenda territorit të vendit tonë, ndërsa në rastet kur subjekti gjendet jashtë vendit dhe dëshiron të heq dorë nga trashëgimia kjo jepet në përfaqësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut para një personi të caktuar që së paku duhet të jetë në rang të konsullit.

“Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia jepet në procesverbal para gjykatësit, ndërsa në përfaqësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut para personit së paku në rang të konsullit”.⁷⁴

Në momentin kur trashëgimtari jep deklaratën, qoftë për pranimin ose mospranimin e trashëgimisë këtui duhet ta bëjë të qartë se në rast të mospranimit të trashëgimisë ai duhet të theksojë faktin se nëse e pranon ose heq dorë nga pjesa që i takon në bazë të ligjit ose testamentit ose deklaratës që ka të bëjë me pjesën e detyrueshme.

“Trashëguesi në deklaratën thekson nëse e pranon ose heq dorë nga pjesa që i takon në bazë të ligjit ose testamentit, ose deklaratës që ka të bëjë me pjesën e detyrueshme”.⁷⁵

Në rastet kur trashëgimtari jep deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia që do të thotë nuk pranon pjesë të trashëgimisë, këtui njëherit duhet të bëhet dallimi dhe të tregohet se heq dorë nga trashëgimia vetëm në emër të vet ose në emër të pasardhësve të vet. Pra, duhet të

⁷³ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 170, paragrafi 1.

⁷⁴ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 170, paragrafi.

⁷⁵ Po aty, neni 170, paragrafi 5.

bëhet një qartësim sa i përket asaj se a bëhet fjalë për heqje dorë personale, vetëm për vetën e tij ose heq dorë në emër të pasardhësve të vet.

“Gjatë dhënies së deklaratës me të cilën heq dorë nga trashëgimia, trashëguesi doemos duhet të jetë i udhëzuar se mund të heq dorë nga trashëgimia vetëm në emër të vet ose në emër të pasardhësve të vet”.⁷⁶

Gjithashtu, është e rëndësishme të caktohet edhe fakti që ajo deklaratë me të cilën nga trashëgimia tërhiqet përfaqësuesi ligjor, patjetër është të ketë pëlqim nga Qendra për Punë Sociale.

“Për deklaratën me të cilën nga trashëgimia tërhiqet përfaqësuesi ligjor, doemos duhet të ketë pëlqim nga qendra për punë sociale”.⁷⁷

4.3. Mbajtja e seancës

Në momentin që mbahet seanca për shqyrtimin e trashëgimisë, duhet të qartësohet fakti që gjykata me kujdesin më të madh dhe me përpikëri diskuton dhe debaton për të gjitha çështjet që lidhen me trashëgiminë. Si lëndë kryesore në rastin konkret, por edhe si një punë që lind pas vdekjes së personit të caktuar, nga momenti i dorëzimit të aktvdekjes në gjykatën kompetente, me të cilën gjykata vërteton kompetencën e saj si dhe në fazat e tjera të shqyrtimit të trashëgimisë, përpos që diskuton dhe debaton për trashëgiminë po ashtu në theks të veçantë diskuton edhe për të drejtën e trashëgimisë si një element individual të asaj se kush ka të drejtë të trashëgojë si dhe për madhësinë e pjesës trashëgimore të çdo trashëgimtari dhe të drejtën për trashëgimtarët. Në tërësi në kuadër të kësaj kuptojmë që është shumë e rëndësishme të diskutohet për trashëgiminë si një tërësi mjaft e rëndësishme, por edhe mbi të drejtën e trashëgimisë, trashëgimtarët, madhësinë e trashëgimisë si dhe për të drejtat për trashëgimtarët.

“Në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë gjykata debaton për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë, ndërsa veçanërisht për të drejtën e trashëgimisë, për madhësinë e pjesës trashëgimore të çdo trashëgimtari dhe të drejtën për trashëgimtarët”.⁷⁸

⁷⁶ Po aty, neni 170, paragrafi 6.

⁷⁷ Po aty, neni 170, paragrafi 7.

Kuptohet që në kuadër të debatit si dhe diskutimit lidhur me këto çështje tentohet të bëhet një zgjidhje më e drejtë dhe më e mirë sa i përket trashëgimisë. Testamenti, si bazë juridike për trashëgimi lehtëson në masë të madhe këtë proces, mirëpo në rastet kur si bazë paraqitet ligji në ato raste nevojiten më shumë diskutime dhe sqarime që të mund të arrihet një vendim sa më i drejtë për të gjithë subjektet lidhur me trashëgiminë.

Kjo nënkuptohet që gjykata nuk merr vendim pa marrë deklaratë nga personat e interesuar, për trashëgiminë dhe të drejtat e tyre.

*“Për këto çështje gjykata vendos, sipas rregullit, pasi do të marrë deklaratë nga personat e interesuar”.*⁷⁹

Në momentin kur ka persona të cilët nuk janë të pranishëm në seancë, ndërsa në mënyrë të rregulltë janë të thirrur, pra mungojnë edhe pse janë thirrur, gjykata këto raste do t'i shqyrtojë në bazë të të dhënave që ajo disponon, duke marrë parasysh deklaratat e tyre me shkrim të cilat po ashtu do të kenë ndikim deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

*“Për të drejtën e personave të cilët nuk kanë ardhur në seancë, ndërsa në mënyrë të rregulltë janë thirrur, gjykata do të shqyrtojë në bazë të të dhënave me të cilat disponon, duke marrë parasysh deklaratën e tyre me shkrim që do të arrijnë deri në marrjen e vendimit”.*⁸⁰

Mund të shtrohet çështja lidhur me deklaratën për trashëgimi që ka të bëjë me pranimin e trashëgimisë ose mospranimin e trashëgimisë, respektivisht heqjen dorë nga trashëgimia. Në këto raste personi i cili pranon trashëgiminë apo heq dorë nga trashëgimia, deklaratë mund ta japë dhe pa praninë e personave të tjerë të interesuar lidhur me këtë gjë.

*“Deklarata për trashëgimi për pranimin e trashëgimisë ose për heqje dorë nga trashëgimia, nuk duhet doemos të jepet në prani të personave të tjerë të interesuar dhe nuk është e nevojshme që në të gjitha rastet personave të tillë t'iu jepet mundësia të deklarohen për deklaratën e personave të tjerë të interesuar”.*⁸¹

⁷⁸ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 171, paragrafi 1.

⁷⁹ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 171, paragrafi 2.

⁸⁰ Po aty, neni 171, paragrafi 3.

⁸¹ Po aty, neni 171, paragrafi 4.

4.4. Ndërprerja e seancës së trashëgimisë

Ka mundësi që gjykata të bëjë ndërprerjen e seancës së shqyrtimit të trashëgimisë. Kjo mundësi ekziston vetëm atëherë kur realisht gjykata vërteton se ka ndonjë kontest për faktet nga të cilat varet ndonjë e drejtë e tyre. Në këto raste gjykata pas vërtetimit të kontestit mes palëve për ndonjë nga faktet nga të cilat varet ndonjë e drejtë e palëve i udhëzon pjesëmarrësit që të ngritin procedurë kontestimore që të mund ta zgjedhin kontestin e tyre ose në procedurë administrative dhe për këtë ligji përmend:

“Gjyqi do ta ndërpresë seancën e shqyrtimit të trashëgimisë dhe pjesëmarrësit i udhëzon të ngritin procedurë kontestimore, përkatësisht administrative nëse ndërmjet pjesëmarrësve ekziston kontest për faktet nga të cilat varet ndonjë e drejtë e tyre”.⁸²

Sa i përket asaj se cilat fakte mund të jenë kontestuese, ligji po ashtu në mënyrë decitive përcakton:

Kontestuese mund të jenë veçanërisht faktet:

- 1) nga të cilat varet e drejta trashëgimore, plotfuqishmëria ose përmbajtja e testamentit ose raporti i trashëguesve dhe trashëgimlënësit mbi bazën e të cilave trashëgohet sipas ligjit;*
- 2) nga të cilët varet baza e kërkesës së bashkëshortit të mbijetuar dhe personave të cilët me trashëgimlënësit kanë jetuar në bashkësi të përhershme, që t’u ndahen nga trashëgimia sendet për amvisëri që shërbejnë për kënaqjen e nevojave të përditshme;*
- 3) nga të cilat varet madhësia e pjesës trashëgimore, dhe veçanërisht përlllogaritja e pjesës trashëgimore;*
- 4) nga të cilët varet baza e përjashtimit të trashëgimtarëve të domosdoshëm ose baza e shkaqeve të padenja; dhe*
- 5) për atë se ndonjë person nëse ka hequr dorë nga trashëgimia.⁸³*

Nga pika e parë e shohim që si fakt kontestues paraqitet si fillim e drejta trashëgimore, që nënkuptohet se kush ka të drejtë të trashëgojë dhe cilat të drejta të tjera janë mbi trashëgiminë, më pas si fakt kontestues mund të paraqitet dhe plotfuqishmëria ose

⁸² Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 173, paragrafi 1.

⁸³ Po aty, neni 173, paragrafi 2.

përmbajtja e testamentit, ku na le të kuptojmë që nevojitet të plotësohen disa kushte që të mund që testamenti të jetë i plotfuqishëm, pra të mund të bëhet zbatimi i të njëjtit dhe përmbajtjes së testamentit, por në rast kur nuk kemi testament, në këto raste trashëgimia bëhet në bazë ligjore dhe këtu si fakt kontestues mund të paraqitet raporti i trashëguesve dhe trashëgimlënësit, pra ky raport mund që në vete të paraqitet si fakt kontestues mes trashëgimtarëve lidhur me të drejtën e tyre në trashëgimi.

Në kuadër të pikës së dytë në disa raste si fakt kontestues mund të paraqitet edhe kërkesa për trashëgimi që mund ta bëjë bashkëshorti që jeton ose që mund ta paraqesin persona të tjerë të cilët me trashëgimlënësin kanë jetuar me një bashkësi të përhershme, të cilët këtë kërkesë e bëjnë duke u bazuar në jetesën e tyre të përbashkët me qëllim që të mund t'u ndahen nga trashëgimia sendet për amvisëri që duhen dhe janë të nevojshme për përditshmëri.

Në kuadër të pikës së tretë si fakt kontestues mund të paraqitet edhe madhësia e pjesës trashëgimore, që realisht është një element mjaft i komplikuar. Mbase secili tenton që të ketë një pjesë më të madhe në trashëgimi dhe mundet që palët të mos ndjehen të kënaqur me pjesën e tyre dhe si pasojë e kësaj ata kërkojnë më tepër dhe nga kjo mund të paraqitet elementi apo fakti kontestues. Mirëpo kërkesa e tyre duhet të jetë e bazuar mbi faktet që ata duhet t'i paraqesin gjykatës.

Në kuadër të grupit të katërt kemi të bëjmë me pjesën e bazës së përjashtimit të trashëgimtarëve të domosdoshëm si dhe me shkaqet se pse të njëjtët mund të përjashtohen nga trashëgimia që në të shumtën e rasteve janë shkaqe të padenja.

Në kuadër të grupit të pestë kjo ka të bëjë me vullnetin e lirë të palëve, për arsye se mundësia e pranimi ose mospranimi të trashëgimisë dhe përzgjedhja e palëve këtu mundëson që dikush të heq dorë nga trashëgimia dhe si pasojë e kësaj edhe këtu mund të paraqitet ndonjë fakt kontestues.

Duke e pasur parasysh që ekzistojnë fakte kontestuese lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë dhe të cilat mund të dërgojnë edhe në ndërprerjen e shqyrtimit të trashëgimisë është e rëndësishme të theksohet se:

*“Nëse në rastet e theksuara nuk ka kontest për fakte, ndërsa kontesti ndërmjet pjesëmarrësve është për zbatimin e së drejtës, çështjet juridike do t’i shqyrtojë gjyqi për trashëgimi”.*⁸⁴

Në këtë normë kuptojmë që në rastet kur nuk ka ndonjë kontest lidhur me faktet të cilat në mënyrë taksative i numëruam dhe sqaruam, atëherë sa i përket çështjeve juridike kompetente është gjykata për trashëgimi.

Ka mundësi që gjatë shqyrtimit të trashëgimisë të ketë ndonjë kontest të caktuar mes palëve, por që nuk do të ndikojë në ndërprerje të seancës së shqyrtimit të trashëgimisë, pra nuk do të thotë që çdo kontest që mund të shkaktohet të dërgojë deri në ndërprerje të seancës. Një rast i tillë ndodh atëherë kur te pjesëmarrësit shkaktohet ndonjë kontest që lidhet me të drejtën e trashëgimitarit ose për të drejtë tjetër të trashëgimisë dhe në këtë rast gjykata nuk bën ndërprerjen e shqyrtimit të trashëgimisë, por vetëm udhëzon palët që të iniciojnë procedurë kontestimore, përkatësisht administrative, mirëpo duke mos e ndërprerë shqyrtimin e trashëgimisë.

4.5. Miratimi i aktvendimit

Në parim pasi të kryhen proceduarat e caktuara të cilat i ndërmerr gjykata, debatet dhe diskutimet nga palët ose subjektet e interesuar gjithmonë në fund të procedurës arrihen deri në një epilog të caktuar, që në rastin konkret procesin e trashëgimisë, në këtë rast gjykata do të sjellë aktvendim. Pra, ky proces përfundon me aktvendim. Në kuadër të kësaj, gjykata pasi vërteton se kujt i takon e drejta e trashëgimisë, nëpërmjet aktvendimit do t’i shpallë ato persona për trashëgimtarë.

*“Gjykata, pasi do të vërtetojë se cilëve persona u takon e drejta e trashëgimisë, me aktvendim do t’i shpallë për trashëgimtarë”.*⁸⁵

Kuptohet që pasi të sillet aktvendimi, ajo që është e rëndësishme është fakti që i njëjti i dorëzohet të gjithë subjekteve të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë. Pra, gjykata bën dorëzimin e aktvendimit subjekteve të cilët në rastin konkret

⁸⁴ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 173, paragrafi 3.

⁸⁵ Po aty, neni 177, paragrafi 1.

janë pasardhësit dhe trashëgimtarët, mirëpo pos këtyre këtu marrin pjesë edhe persona të cilët gjatë procedurës kanë theksuar kërkesë për trashëgimi.

“Aktvendimi për trashëgimi do t’u dorëzohet të gjithë pasardhësve dhe trashëgimtarëve, si dhe personave të cilët gjatë procedurës kanë theksuar kërkesë për trashëgimi”.⁸⁶

Në rast kur pasardhësit kontestojnë një trashëgimi të caktuar, mirëpo nuk e kontestojnë trashëgimtarin, atëherë gjyqi me propozim të trashëgimtarit, do të miratojë aktvendim të posaçëm për atë trashëgimtar dhe një gjë të tillë do ta bëjë para se të miratojë aktvendim për trashëgimi.

“Nëse pasardhësit nuk e kontestojnë trashëgimtarin, gjyqi me propozim të trashëgimtarit, të miratojë aktvendim të posaçëm për trashëgimtarin dhe para se të miratojë aktvendim për trashëgimi”.⁸⁷

⁸⁶ Ligji për procedurën jashtëkontestimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, neni 178.

⁸⁷ Po aty, neni 181.

PËRFUNDIMET

Gjatë këtij hulumtimi kemi shtjelluar temën me të cilën çdokush është përballur apo do të përballët në të ardhmen. I gjithë procesi i shtjelluar gjatë punimit është i lidhur ngushtë me çdo person fizik.

Jemi munduar në detaje të analizojmë temën dhe gjatë procesit të hulumtimit kemi arritur nga afër të shohim se me çfarë problemesh hasen personat gjatë kësaj procedure. Mënyra e funksionimit të sistemit në Republikën e Maqedonisë së Veriut e vështirëson dhe e komplikon aplikimin e ligjit dhe procedurave ligjore.

Për shkak se lindja dhe vdekja janë një proces natyral të cilët nuk ndalen ndaj dhe kërkesat për kompletimin e procedurave apo dokumentacioneve janë të pandalshme. Andaj angazhimi i institucioneve shtetërore ndaj sistemeve elektronike do të ishte një zgjidhje mjaft e mirë për tejkalimin e pritjeve dhe lehtësimin e të gjithë procedurës.

Gjatë hulumtimit gjithashtu jemi munduar të marrim dhe të dhëna statistikore në Gjykatën Themelore se sa është numri i procedurave gjyqësore ku shpallet personi i zhdukur për të vdekur, por fatkeqësisht kem marri përgjigje se gjykata nuk mban statistika të tilla. Të dhënat e Ministrisë së Brendshme tregojnë se që nga viti 2010 në po atë ministri janë paraqitur gjithsej 68 persona të humbur nga mosha të ndryshme, kryesisht madhore.

Intervistën të cilën e kemi bërë me noteren Majlinda Ajdari për rastet e përpilimit të testamentit se sa të shpeshta janë ata në vendin tonë, u informuam se testamenti te ne praktikohet shumë rrallë. Më së shumti trashëgimia trashëgohet me anë të Kontratës së Alimentacionit të Përjetshëm, Kontratën e Dhuratës si dhe me anë të marrëveshjes së shpërndarjes së pronës gjatë jetës. Mosha mesatare e personave të cilët përpilojnë testament është ajo gjashtëdhjetë vjeç. Ndërsa ndryshimi i testamentit bëhet shumë rrallë. Në të shumtën e rasteve hapja dhe shpallja e testamentit bëhet në gjykatë, ndërsa noteri vazhdon me procedurën e trashëgimisë.

REKOMANDIMET

Pas një studimi të gjatë dhe duke e analizuar të gjithë procedurën nga afër në të gjitha etapat mund të konstatojmë se ekzistojnë disa procedura të cilat nëse do të ekzistonte ndonjë bazë elektronike, ku do të mund të kishin hapësirë të gjitha subjektet të cilat janë të involvuara gjatë procedurës, atëherë gjithçka do të ishte më e thjeshtë dhe më praktike. Sistemi i dobët i instaluar nëpër institucione qofshin ata shëndetësore apo të tjera bën që e gjithë procedura të ngadalësohet, por edhe në disa raste të ketë ngecje. Dhe si shkak i gjithë kësaj kemi rezultatin e pritjeve të shumta nëpër sportelet e institucioneve shtetërore.

BIBLIOGRAFIA

- Blagojević B., “Gragjanski postupak u rimskom pravu”, Beograd, 1960.
- Aliu, A. “E drejta civile”, Prishtinë, 2013.
- Rašović, Zoran, “Građansko pravo”, Crne Gore, 1997.
- Gams, A, “Uvod u građansko pravo: opšti deo”, Naučna knj., 1967.
- Rodna Zhivkovska, “Stvarno Pravo”, Skopje 2005.
- K, Boshkovski, “Medicinska Etika i Deontologija”, Skopje 2007.
- Oliver Autic, “Nasledno pravo”, Beograd, 2004.
- Mile Vasilijev, “Nasledno pravo”, Skopje, 1983.
- B. Stojavoic-Antic, “Uvod u gragansko pravo”, Beograd, 2001.
- A. Aliu, Rr. Qehaja, “E drejta trashëgimore” Prishtinë, 2007.
- Verdis, M. dhe Kralic, P. Gragjansko Pravo, Zagreb, 2003.
- Janevski Arsen, E drejta procedurale civile, Shkup, 2011.
- A. Abdulla, “E drejta sendore (pronësia)”, Prishtinë, 2009.
- A. Aliu, “E drejta sendore-pronësia” Prishtinë, 2006.
- A, Aliu, “E drejta e autorit”, Prishtinë, 2004.
- Ivo, Puhane, E drejta romake”, Prishtinë, 1989.
- Nerxhivane, Dauti, “E drejta e detyrimeve”, Prishtinë, 2004.
- Oliver B. Antić, “Nasledno pravo”, Beograd, 2010.
- Cavdar, Kiril, “Zakon za Vonparnicna postapka”, Skopje, 2008.
- Georgievski S., “Komentar na zakonot za vonprocesnata postapka”, Skopje, 1989.
- Boskovski, Karpos, “Medicinska Etika i Deontologija”, Skopje, 2007.
- A. Grupçe, “Gragjansko pravo”, Opsht del, Skopje, 1976.
- Podvorica Hamdi, “E drejta trashëgimore”, Prishtinë, 2006.
- Çavdar, Kiril, “Komentar na zakonot za nasleduvaniето”, “Akademik”, Skopje, 1996.
- Strucno Spisanie, “Notarius”- Notarska Komora na Republika Makedonija, Skopje.

Akte ligjore, kode

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1991;
- Gazeta zyrtare e RM-së nr. 47/96, Ligji mbi Trashëgiminë, E drejta familjare, 12 shtator 1996;
- Dejan, Mirkovic I Angel Ristov, Zakon za Nasleduvanie, Skopje, 2015;
- Ahencia “Akademik”-Skopje, Zakon za Vonparnicna postapka, Skopje, 2008;
- Sl. Vesnik na R .M., br. 09, Zakon za vonparnicna postapka, od 18.01.2008, Skopje;
- Sl. Vesnik na R. M., br. 55, Zakon za Notarijatot, od 04.05.2007;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950;
- “Zakon za nasleduvanjë” na RSM, Redakciski precisten tekst, sl. ves. na RSM;
- Tek i konsoliduar Zakon za maticna evidencija („Службен весник на Република Македонија“ бр. 8/1995, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/2013, 43/2014, 148/2015 и 27/2016);
- Zakon za drzavna statistika na RSM Службен весник на Република Македонија” бр. 54/1997, 21/2007, 51/2011, 104/2013 , 42/2014, 192/2015, 27/16, 83/18, 220/18, 31/20;
- Zakon za Zdrastvena Zastita (Службен весник на РСМ бр. 43 од 2012 godina) dhe ndryshimet deri te бр. 37 од 26.2.2016 година;
- Zakon za sanitarnata i zdrastvenata ispekcija na RM, sl.ves. na RM, br. 71 od 2006;
- Regullore për kushtet dhe mënyrën e varrimit, zhvarrimit dhe bartjes së trupit të vdekur, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21 shkurt 2008;
- Graganski zakonik na RSM;
- Kodi penal i RMV;
- Ligji për trashëgimi të Kosovës, 2005.

Praktika gjyqësore

Të dhëna nga PHI Klinika Universitare për Ndërhyrje Kirurgjike “St. Naum Ohridski-Shkup”;

Intervistë me noteren Majlinda Ajdari, Shkup, 2022.

Burime nga interneti

<http://www.pravo.org.mk/>

<http://www.pravdiko.mk/ëp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-vonparnichna-postapka-18-01-2008.pdf>

<http://pravda.gov.mk/documents/Zakon%20za%20notarijatot%20sl.vesnik%20br.55.07.pdf>

www.akademik.mk

<https://www.pravdiko.mk/prijavuvane-na-pochinato-litse-i-izdavane-na-izvod-od-maticna-kniga-na-umreni/>

ИЗВОД ОД МАТИЧНАТА КНИГА НА УМРЕНИТЕ
CERTIFIKATË NGA LIBRI AMZË I TË VDEKURVE

ОПШТИНА _____

ГРАД _____

КОМУНА _____

ОУТЕТИ _____

Во матичната книга на умрените што се води за местото _____ под

Në librin e amzës për të vdekurit që mbahet për vendin _____ nën

тековен број _____ за година _____ запишана е смртта на:

numrin mjedhës _____ për vitin _____ është regjistruar vdekja e:

Име: Emri:		Пол: Gjinia
Презиме: Mbiemri:		
Ден, месец, година и час на смртта: Dita, muaji, viti dhe ora e vdekjes		
Место на смртта: Vendi i vdekjes		
Ден, месец и година на раѓањето на умрениот: Dita, muaji dhe viti i lindjes të vdekurit		
Место на раѓањето: Vendi i lindjes		
Државство: Shtetësia		Матичен број: Numri i amzës:
Последно живеалиште и адреса на станот: Vendbanimi dhe adresa e fundit		
Брачна состојба: Gjendja martesore		
Презиме пред склучување на бракот: Mbiemri para lidhjes së martesës		
Име и презиме на сопругот за и презимето пред бракот: Emri dhe mbiemri i bashkëshortit-tas e dhe mbiemri para lidhjes së martesës		
Име и презиме на родителите: i babait		
Emri dhe mbiemri i prindërve:	на мајката: i nënës	

Забелешки:

Верифику:

Бр.
Nr. _____ 20 _____ год.
viti _____(МП)
(V.V.)Потпис на матичарот
Nënshkrimi i ofiqarit



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ТРАНСПОРТ И ВРСКИ

Број на дозвола

85/2016

ДОЗВОЛА
ЗА ВРШЕЊЕ НА ПОГРЕБАЛНИ УСЛУГИ

Трговско друштво КАСПЕР КОМПАНИ ДООЕЛ увоз-извоз Свети Николе, со
седиште на ул. Орце Николов бр.97 Свети Николе, со ЕМБС 7158238
(назив, седиште и ЕМБС на правното лице/име, презиме, живеалиште и ЕМБГ на физичкото лице)

Се издава дозвола за вршење на погребални услуги.

Со рок на важење на дозволата: 24.11.2021 година

Скопје 24.11.2016

(место и датум на издавање)




МИНИСТЕР



Република Македонија
Државен завод за статистика

ПОТВРДА ЗА СМРТ И ЛЕКАРСКИ ИЗВЕШТАЈ ЗА ПРИЧИНАТА ЗА СМРТ

Податоците што се прибираат по овој извештај претставуваат лични податоци
заштитени согласно Законот за државната статистика

Член 26 од Законот за државната статистика
("Службен весник на Република Македонија"
бр. 54/97, 21/07 и 51/11); и Подзаконикот за
статистички истражувања 2008 2012 ("Службен
весник на Република Македонија" бр. 11/08 и 141/10)

Име на институцијата што ја издава потврдата Реден бр. _____

1. ИМЕ И ПРЕЗИМЕ НА УМРЕЖИОТ	
2. ПОЛ ☐ Машко ☐ Женско	
3. ДАТА НА СМРТТА _____ во _____ (0-24 часот) ден месец година	
4. НАСЕЛЕНО МЕСТО НА СМРТТА _____ ОПШТИНА _____ Улица _____ Куќан бр. _____	
5. ДАТА НА РАГАЊЕ И ЕМБГ _____ Св. умрено дојчице, до 1 година старост, да се наведе ЕМБГ на мајката ден месец година останати 6 цифри на ЕМБГ ЧБГ за деца до 1 месец (0-24)	
6. НАСЕЛЕНО МЕСТО НА РАГАЊЕ _____ ОПШТИНА _____ ДРЖАВА _____	
7. МЕСТО НА ЖИВЕЊЕ (според официјалната адреса на живеење) Улица _____ Куќан бр. _____ НАСЕЛЕНО МЕСТО _____ ОПШТИНА _____ ДРЖАВА _____	
8. БРАЧНА СОСТОЈБА (законска) ☐ неженет/незамжена ☐ женет/замжена ☐ вдовеч/вдовичка ☐ разведен/разведена	9. ДРЖАВЈАНСТВО _____
10. ПРИПАДНОСТ КОН ЕТНИЧКА ЗАЕДНИЦА _____	11. ИМЕ на родителите Татко _____ Мајка _____
12. ЗАНИМАЊЕ _____ (Св. умрено дојчице се наведува занимањето на мајката)	
БЕЛЕШКА ЗА МАТИЧАРОТ: Овој случај е запишан во Матичните книги на умрелите каде се води за место под тековен број _____ на _____ (м.п.) датум на запишување Потпис на матичарот _____	

13. СМРТТА Е: ☐ ПРИРОДНА ☐ НАСИЛНА ☐ несреќен случај ☐ самоубиство ☐ убиство (да се означат видот на насилната смрт)	
14. ДАЛИ УМРЕНОТО ЛИЦЕ БИЛО ЛЕКУВАНО ОД БОЛЕСТА ОД КОЈА УМРЕЛО ☐ Да ☐ Не а) Дата на последен припад _____ б) Број на здравствениот картон _____ в) Име на здравствена установа _____	
15. МЕСТО НА СМРТТА (да се означат еден од дадените модалитети) ☐ Во здравствена организација (болница, санаториум, амбуланта и сл.) ☐ Во стан (за живеење, колективно живеење и сл.) ☐ Во друго место (работни простори, поле шума, улица и сл.)	
16. СМРТТА ЈА УТВРДИЛ: ☐ ЛЕКАР ИЛИ ДРУГО ЗДРАВСТВЕНО ЛИЦЕ ☐ ДРУГО ЛИЦЕ Презиме и име на лицето што ја утврдило смртта _____ Потпис _____	
17. ПРИЧИНА ЗА СМРТ I. а) Болест или состојба која непосредно довела до смрт _____ б) Претходни причини _____ в) Морбидни состојби (ако постојат, кои ја предизвикале горната причина ставајќи ја основната причина последна) _____ г) ОСНОВНА ПРИЧИНА ЗА СМРТ _____ НАДВОРЕШНА причина за смрт _____ II. Други значајни состојби што можеле да влијаат да дојде до смрт, но не се во врска со болеста или состојбата која предизвикала смрт _____ Потпис на лекарот _____ Име и презиме на лекарот што ја дал причината за смрт	
18. ПОДАТОЦИ ДАДЕНИ ОД ОБДУКЦИОНЕН НАОД (ако умрениот е обдуциран) бр. _____ (м.п.)	

**Извештај
за стационарно
лекувано лице**

Обр. бр. 3-21-61А

1. Организација на здружениот труд од областа на здравството

(назив и општина)

2. Болница стационар

(назив и општина)

3. Организациона единица (служба / одделение)

(назив и општина)

4. Презиме и име

5. Адреса (место и општина)

6. Број на историја на болеста

7. Матичен број на осигуреникот

8. Датум на раѓање, ден

месец

година

9. Пол

Машки

Женски

10. Работа која ја врши

11. Регистарски број на осигуреникот

12. Категорија на здравственото осигурување

-- Работничко осигурување

активни осигуреници

останати осигурени лица

-- Земјоделско осигурување

-- Неосигурани лица

13. Инвалидитет на трудот

Да

Не

14. Датум на приемот, ден

месец

година

15. Датум на исписот (отпишувањето), ден

месец

година

16. Основно заболување, природа на повредата, односно состојбата поради која е лекуван, односно вршена рехабилитација (по МКБ)

16а. Извршена операција, ден

месец

година

17. Повреда

на работа

на пат или враќање од работа

во домот

останати повреди

18. Надворешна причина на повредата (по МКБ)

19. Време на повредата, час

ден

месец

20. Рехабилитација

оспособен за својата работа

оспособен за работа со промена на работно место

оспособен за работа под услов да се преквалификува

оспособен само за вршење секоедневни неопходни активности

оспособен за работа во скратено работно време

лекуван без успех

21. За умрени основна причина на смртта (по МКБ)

22. Обдукција извршена

Да

Не

Во Скопје

Датум 09 02 2021

(Презиме и име на лекарот)

(Потпис на лекарот)

ПОТВРДА ЗА СМРТ И ЛЕКАРСКИ ИЗВЕШТАЈ ЗА ПРИЧИНАТА ЗА СМРТ

Податоците што се прибираат со овој извештај претставуваат лични податоци,
заштитени согласно Законот за државна статистика

Име и презиме на умрениот: _____

Пол: _____

Датум на смртта: _____ во _____ (0 - 24 час)

За медицинска установа

Здравствена установа _____

Населено место, Општина Скопје, Центар

ЕМБГ _____

ЕМБГ на мајката (само за умрено доенче до 1 година старост)

Час, за деца до еден месец _____

Адреса на живеење _____

Населено место, Општина _____

Држава _____

Брачна состојба _____

Државјанство _____

Национална припадност _____

Занимање _____

Име на татко _____

Име на мајка _____

Основна причина за смрт _____

Надворешна причина за смрт _____

Лекар _____

БЕЛЕШКА ЗА МАТИЧАРОТ: Овој случај е запишан во матичната книга на умрените која се води

за место _____ општина _____

под тековен број _____ на _____

датум на запишување _____

потпис на матичарот _____

Презиме и име на лекар _____

СПРОВОДНИЦА ЗА ПРЕНЕСУВАЊЕ МРТОВЕЦ

A. ПОДАТОЦИ ЗА МРТОВЕЦОТ:

1. Семејно/за мажени жени моминско/татково и родено име.....
2. Ден, месец, година, место и земја на раѓањето.....
3. Државјанство.....
4. Час, ден, месец, година, место и земја кога и каде настапила смртта.....
5. Причина на смртта/на латински и народен јазик/.....
6. Дали мртовецот бил закопан ДА - НЕ

B. ДРУГИ ПОДАТОЦИ:

1. Место, околија, република односно земја во која се пренесува мртовецот.....
2. Превозно средство со кое ќе се изврши превозот и начин на превоз.....
3. Место на преминот на државната граница.....
4. Начин на кој е утврден идентитетот на мртовецот.....
5. Број на одобрението за пренесување на мртовецот и назив на органот кој го издал одобрението.....
6. Одобрението е издадено на барање на:
7. Пренесување на мртовецот се врши во придружба на.....

Бидејќи причината на смртта е ЗАРАЗНА - НЕЗАРАЗНА болест, од опремата на мртовецот е извршена на начинот пропишан во член 5 на Правилникот за условите и начинот за ископување и пренесување мртвови метален - дрвен - метален и дрвен сандак

.....
/датум на издавањето на
спроводницата/

/М.П./

.....
/Потпис на издавателот
на спроводницата/

FALËNDERIM

Falënderoj nga zemra të ndjerën Prof. Emine Zendeli. I gjithë procesi i përgatitjes së temës ishte në bashkëpunim, rekomandim dhe në vëzhgim të saj. Fatkeqësisht fati nuk deshi që të njëjtin ta mbrojë para saj.

U prefsh në paqe e dashur!